



NE VIJME..
NE EDHE SHKOJME..!



QYTETËRIMI I FJALËS



ISLAMI NGA LIBRI
DHE ISLAMI NGA JETA

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 6 (208), Qershor, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

MYFTIU: "TEK NE NUK KA RACIZËM!

Në Islam njerëzit janë të barabartë..!"



FERMANËT SULTANORË SI FORMA TË DHËNIES SË TË DREJTËS NDËR SHQIPTARËT

Kjo tolerancë fetare brenda këtyre fermaneve nuk shprehet vetëm në raportet e vendosura me klerin ortodoks po dhe atë katolik.

Në mjaft fermanë flitet për urdhëra të lëshuar për ndërtim kishash katolike në qytete të ndryshme, si Durrës, Prevezë, Shkodër, etj.

Me mjaft interes është korrespondenca e sulltanit me ipeshkëvin e Shkodrës për ndërtim manastiri në Shkodër, për ndërtimin e katedrales, për ngritjen e një instituti françeskan po në këtë qytet.

Është për t'u çuditur se korrespondenca është bërë në dy gjuhë, atë osmane dhe italiane."

BASHKËBISEDIM ME MYFTIUN E SHKODRËS MBI AKTIVITETIN E MYFTINISË GJATË PANDEMISË

(Nga bashkëbisedimi i gazetarit Erzen Koperaj me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në emisionin e përjavshëm "Tonight" në Star Plus Tv – Shkodër, më 17 qershor 2020)

Gazetari: Të nderuar shikues të "Star Plus", mirëmbërë dhe mirëseerdhët në emisionin tonë të përjavshëm "Tonight". Jemi drejtpërsëdrejti dhe ky është emisioni i dytë pas periudhës së karantinës. Sonte kam nderin të kem të ftuar në studio Myftiun e Shkodrës Imam Muhamed Sytari. Z.Sytari mirëmbërë dhe mirëseerdhët në "Tonight".

Myftiu: Faleminderit dhe kënaqësi që takohemi!

Gazetari: Pa dyshim që kemi kaluar një prej periudhave më të pazakonta, jo vetëm në aspektin shoqëror, por edhe atë fetar, mund të themi se anomali të kanë qënë më të dukshme. Gjatë kësaj periudhe të karantinës, kemi pasur edhe një prej ngjarjeve më të mëdha për besimtarët muslimanë, muajin e shenjtë të Ramazanit. Ne e kemi shikuar si e kanë përjetuar besimtarët por, do të na interesonte, ashtu siç e kanë përjetuar drejtuesit e institucionit të myftinisë këtë periudhë.

Myftiu: Subhanallah, është e vërtetë se kjo periudhë ka qënë një moment reflektimi për gjithsecilin prej nesh për të kuptuar sesa e vogël është bota e jonë sot, dhe sesa i dobët është njeriu përballë zhvillimeve të saj. Kemi parë dhe përjetuar momente shumë interesante, diku të vështira diku të dhimbshme, por që gjithsesi nuk e kemi humbur shpresën në asnjë moment dhe nuk kemi toleruar, e lejuar që të biem në panik pavarësisht se propagandat dhe thirrjet drejt panikut, e deklarimet e herëpashershme në lidhje me këtë situatë, kanë nxitur panik tek njerëzit dhe vazhdojnë të nxisin panik, pavarësisht se sot nuk flitet për këtë situatë sikurse është folur para 3 apo 4 muajve, andaj njerëzit janë ndërgjegjësuar dhe kanë kuptuar shumë të vërtetat e kësaj situatë.

Natyrshtëm për ne si besimtarë, për komunitetin tonë, për bashkësinë tonë fetare dhe besoj për të gjitha komunitetet fetare ka qënë një sprovë ndryshe prej sprovave të viteve e

periudhave të kaluara. Nuk është hera e parë që ne kemi qëndruar larg xhamive, apo objekteve tona të adhurimit, sikurse ka pasur momente të tjera në historinë tonë kombëtare e të njerëzimit, ku jemi privuar nga frekuentimi i rregullt, e i natyrshtëm i objekteve të adhurimit. Mirëpo, kjo e kohëve të fundit, ishte pak më e gjatë dhe ishte e rrethuar me dilema të shumta..?!

televizioneve tuaja.

Gazetari: Megjithatë kanë kaluar tre javë, sikurse e përmenda dhe më përpara, nga koha e një Ramazani'më të veçantë'. Pa dyshim, ajo që i ka munguar më së shumti besimtarëve, të cilët i falënderoj që na ndjekin dhe na shkruajnë mesazhe në këtë moment, është një prej mungesave që kanë pasur në faljen e teravive.

Myftiu: Ne themi se,

"pas çdo vështirësie, vjen lehtësimiti" dhe themi se çdo sprovë duhet gjykuar me nerva të ftohta. Përballimi me sprovat në momentin e parë, shpeshherë sjell edhe reagime emocionale ose reagime për të cilat mund të pendohejmë më vonë. E vërteta është se kjo sprovë ka pasur, shumë të mira të mëdha për krejt besimtarët, pasi

ne kemi qënë disa herë në ditë pranë besimtarëve me ligjëratat e këshilla të ndryshme që janë transmetuar live në kohë edhe nga mediat lokale të Shkodrës që duhen falënderuar shumë për këtë.

Janë transmetuar ligjërimet dhe këshillat fetare të krejt drejtuesve fetarë të Shkodrës e të gjithave besimeve, dhe kjo është një e mirë e madhe që i ka ndihmuar e dhuruar, ngrohtësi e mirësi, në ato dritare në oraret e caktuar. Por, njëkohësisht ne kemi udhëzuar njerëzit që shtëpitë t'i kthejnë në xhamia.

Kujtoj, hytben e xhumasë së parë në një prej xhamive të Damaskut, menjëherë mbas lirimit të lëvizjes, një prej pedagogëve tanë, prej medimtarëve të shquar të fesë islame në Damask të Sirisë, mbante një hytbe që thoshte: "Xhamive ju kthyer, mirëpo a jemi kthyer realisht Zotit tonë?", që do të thotë se thelbi i krejt thirrjeve në këto ditë, ka qënë që njerëzit të mos humbin lidhjen, e shpresën me Zotin e gjithësisë.

Është e vërtetë se na kanë munguar namazet e teravisë në xhamitë tona! Nga eksperiencia ime, edhe si autor i disa librave, ku kam përmbledhur eksperiencën e vizitave në xhami të

ndryshme të Shkodrës, por jo vetëm, në netët e Ramazanit.

Natyrshtëm që është një atmosferë e jashtëzakonshme kur takohesh me njerëz, vijnë besimtarë të të gjithave moshave, ata që mësyjnë derën e Zotit, edhe në orë të vona të natës. Në kohën e verës, teravia shkonte deri në mesnatë...

Është e vërtetë se na ka munguar harmonia dhe gëzimi i namazit të teravisë me xhamat, në xhamitë tona, në pjesën dërrmuese të Ramazanit, mirëpo në këtë Muaj kemi fituar diçka shumë të madhe, që është gjallërimi i shtëpive tona me përmendjen e Zotit, e me faljen e namazit me krejt familjarët. Kemi përjetuar momente shumë të gëzueshme, kur fëmijët tanë na kanë drejtuar në namaz! Pra, janë mësuar fëmijët tanë të na prijnë në faljen e namazit të teravisë, kanë garuar vëllau me vëllanë se kush do e drejtojë njerin namaz apo namazin tjetër. Kemi qënë shumë të përpiktë që mos të humbasim asnjë prej namazeve me xhamat, brenda familjeve e shtëpive tona.

Kjo është një mirësi e bekim shumë i madh për çdo familje, prej familjeve myslimane të Shkodrës. Me të shumtën e njerëzve, me të cilët kam komunikuar, që kemi ndarë përshëndetjet, pyetjet, interesimin për muajin e madhërueshëm të Ramazanit; pothuajse të gjithë m'a kanë konfirmuar këtë fakt, që në shtëpitë myslimane të Shkodrës, është falur namazi i teravisë në këtë mënyrë. Njëherë ka prirë babai, njëherë djali i madh, e herë tjetër djali i vogël. Janë mbledhur brenda fisit dy a tri familje, dhe kjo patjetër që lë një kujtim shumë të mirë, sidomos tek brezi i ri, tek fëmijët. Pra, ka qënë një Ramazan ndryshe nga të tjerët, që gjithsesi kishte dritën e bekimet e tij, sikurse dhe shpërblimin nga Zoti i gjithësisë.

Gazetari: Në fakt ajo që shoh edhe prej mesazheve që vijnë në këtë moment, normalisht e quajnë të veçantë, por ajo që doja të pyes ka lidhje me atë që përmendët edhe ju më parë, "kjo periudhë na ka bërë që të kthehemi drejt disa të vërtetave...". Sikurse duke shikuar në komentet e lajmërimit në rrjetet sociale, në profilin tonë, bie pyetja: "A mendoni se kjo situatë na ka bërë që t'i shohim me një sy tjetër, apo ti afrohemi këtyre të vërtetave që ju përmendët më parë?"

Myftiu: Shiko, unë mendoj se argumentet e shumta në Kur'anin Famëlartë, kur flasin për sprovat me të cilat përballlet njeriu në jetë, përfshijnë të gjitha kategoritë e njerëzve. Ka kategori njerëzish që përballen me sprovë nga më të ndryshmet dhe

NË SHUMË PREJ XHAMIVE TONA SOT, KA SHUMË MË TEPËR DJEM TË RINJ DHE VAJZA TË REJA, QË VIJNË TË FREKUENTOJNË JO VETËM NAMAZIN E XHUMASË, POR EDHE NAMAZET E TJERA, SESA PARA PERIUDHËS SË TË ASHTUQUAJTURËS PANDEMI GLOBALE.

nuk ndryshon asgjë në sjelljen, në ndërgjegjen, në komunikimin, në sjelljen e tyre! D.m.th, ato janë shumë të ftohtë përballë sprovave. Por, ka shumë njerëz që sprovat i mësojnë për t'u kthyer për të pasur një moment reflektimi, pendimi, për të menduar sa të vegjël jemi dhe sa nevojtarë për mëshirën e Zotit jemi!

Të shkëputemi pak në kohë, nga periudha e kësaj që kaluam dhe vazhdojmë të kalojmë me drejthijën e saj. Ja, periudha e tërmeteve! Jemi në një hark kohor, rreth katër apo pesë muaj, rreth një gjysëm viti që përballemi me sprovë nga më të ndryshmet. Diku tërmete, diku zjarre, diku ky i ashtuquajtur i karantinim, apo distancim, njëherë social, njëherë fizik, (kjo loja paradoksale me termat?!), janë sprovë, që duhet ta zgjojnë njeriun për të kuptuar se kjo jetë është shumë e shkurtër.

Mirëpo kjo botë, kjo jetë e kjo gjithësi e kanë një Zot, dhe Zoti i gjithësisë komandon çdo gjë në këtë botë! Njeriu që me zemër e shpirt drejtohet tek Zoti i tij, i përjeton sprovat me shumë qetësi e duke përfutur prej tyre sepse çfarëdo që të vijë është e mirëseardhur nga Zoti i gjithësisë. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: "Thuaj, nuk do të na godasë, përveç asaj që na ka shkruar Zoti!", që do të thotë se në momentin e sprovave besimtari i vërtetë është shumë i qetë!

Meqenëse përmendëm edhe tërmetet, kemi ndjekur besimtarë a prijës fetarë, duke folur për mesele të ndryshme, live në transmetime televizive, kur papritur ka ndodhur një lëkundje e madhe tërmeti. Në të shumtën e rasteve ata janë shumë sherbes, shumë të qetë. Normal, frika është pjesë e natyrës së njeriut, mirëpo paniku nuk ka vend në fjalorin, e jetën e besimtarit, andaj ne kemi nxitur,

porositur e folur pothuajse në mënyrë të vazhdueshme gjatë kësaj periudhe, duke këshilluar distancimin nga paniku.

Madje, kemi kritikuar deklarata të ndryshme që kanë ardhur nga drejtues të ndryshëm të vendit, deklarata që nxisin panik, ose përdorimi i disa termave të ekzagjeruara që në vend që ta lehtësojnë gjendjen emocionale dhe psikologjike të njerëzve, e rëndojnë, e vështirësojnë atë. Ndërkohë, në fjalorin e jetën e besimtarit nuk ka vend për to!

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'anin Famëlartë, se do t'ju sprovojmë me urinë, me vdekjen dhe me sprovë nga më të ndryshmet. Mirëpo thotë poashtu që, jepu shtetësi besimtarëve, të cilët kur goditen nga këtë sprovë, thonë: "Të All-llahut jemi, dhe tek All-llahu do të kthehemi". Pra, Zoti i gjithësisë nëpërmjet këtij ajeti përkthen qetësinë në zemrën, shpirtin e jetën e besimtarit.

A mundemi ne t'a parandalojmë një tërmet si ai që ra në Durrës? A mundemi t'a parandalojmë një tërmet si ai që ra edhe në Shkodër gjithashtu, para disa muajve? Ai ka kishte lëkundje shumë të forta, edhe dëmtime, por jo si ato të zonave të tjera të prekura rëndë. A mundemi t'i parandalojmë? Jo, nuk mundemi dot. Atëherë pse duhet të kemi panik? Nuk ka vend për panik, kur asgjë nuk është në dorën tonë!

Ajo që ka spikatur në këtë periudhë është që, shumë njerëz me të cilët kemi qënë në kontakt të vazhdueshëm, dhe vazhdojmë të kontaktojmë, i ka shërbyer për mirë kjo periudhë kohore. Po marr si një njësi matëse, (që gjithsesi nuk është e vetmja), frekuentimin e xhamisë në këtë moment që flasim.

Po them me përgjegjësinë më të madhe se në shumë prej xhamive tona sot, ka shumë më tepër djem të rinj dhe vajza të reja, që vijnë të frekuentojnë jo vetëm namazin e xhumasë, por edhe namazet e tjera, sesa para periudhës së të ashtuquajturës pandemi globale.

Jam i bindur se një pjesë të mirë prej tyre, u ka shërbyer kjo periudhë disa mujore e të izoluarit, për besimin, për të kuptuar vetveten, marrëdhënien me jetën, me familjen, me besimin, shumëçka që lidhet me jetën e përditshme.

Një njësi tjetër matëse, është edhe komunikimi dhe marrëdhënia e njerëzve me disa fenomene të cilat i kemi kritikuar, përpara kësaj periudhe. Mbrëmë pyeta një zotni, këtu në Shkodër, për frekuentimin e lokaleve, konsumimin e alkoolit, i thashë po të bëj një pyetje:

Si konsumohet alkooli sot? Ma ktheu: “Në të vërtetë ka rënë shumë konsumimi i alkoolit!”. Vazhdova ta pyes: Arsyeja? Tha: “Nuk e di cila është arsyeja, ndoshta gjendja ekonomike, nuk jam i sigurt, por në krahasim me periudhën e parahapjes së lokaleve, ka rënë shumë konsumimi i alkoolit!”. Pse ka rënë konsumimi i alkoolit? Pse?

Unë them se është një prej shkaqeve që kemi kaluar, pra ka njerëz që janë vetëdijesuar, që kanë bërë tobe, që janë penduar, që kanë hequr dorë nga veprime të dëmshme për shëndetin, familjen, për ekonominë e tyre. Ka njerëz që janë kthyer nga besimi, që janë bërë lexues të rregullt të Kur’anit, janë bërë pyetës të rregullt, unë sot pyetem shumë më tepër seç jam pyetur më përpara, nga djem të rinj, njerëz nga gjithandej përbrenda kufijve, por edhe nga jashtë.

Jam i bindur se këto janë efektet pozitive të kësaj sprove që kemi kaluar së bashku dhe akoma vazhdojmë të përpëlitemi në pasojat e saj.

Gazetari: E zgjas pyetjen e mëparshme, ku ju përmendët atë që e dallon besimtarin në këtë situatë, është qetësia ndaj panikut. Çfarë e bën kaq të qetë dhe të fortë, për të përballuar fatkeqësitë, një besimtar?

Myftiu: Qetësia që dhuron besimi, përballë çdo paniku e sprove! Përgjigjja më e mirë janë shembujt nga jeta e pejgamberëve të përmendur në Kur’anin Famëlartë. E kam trajtuar këtë temë, në disa prej ligjëratave të këtij Ramazani, në mbrëmje para yftarit. Janë disa momente shumë interesante në Kur’anin Famëlartë, ku Zoti i gjithësisë përmend shembuj nga jeta e shumë prej pejgamberëve, që janë sprovuar në mënyra të ndryshme. Njerëzit më të sprovuar në këtë botë janë pejgamberët! Njerëzit më të sprovuar, janë ata që janë më afër Zotit të gjithësisë.

Rasti i Hz. Ibrahimit (a.s.)! Hz. Ibrahim është duke u hedhur në zjarr. Është ndezur një zjarr i madh nga paria e Nemrudit, sepse ai zotëri kundërshtonte idhujtarinë! Ata, putnat i kishin të shenjtë, dhe vendosin ta eliminonjë fizikisht për hakmarrje. Ta eleminojnë në një mënyrë të frikshme, të llahtarshme, ta hedhin në një zjarr të madh, me katapultë.

Në këtë moment, Hz. Ibrahimit (a.s.) i vjen melekui më i madh, Hz. Xhibrili (a.s.) dhe i thotë: “A ke diçka nevojë për mua?” – “Për ty, jo!”, ia kthen i Dërguari i All-llahut.

– “Po për Zotin e gjithësisë?”, vazhdon melekui.

QETËSIA QË DHURON BESIMI, PËRBALLË ÇDO PANIKU E SPROVE! PËRGJIGJJA MË E MIRË JANË SHEMBUJT NGA JETA E PEJGAMBERËVE TË PËRMENDUR NË KUR’ANIN FAMILARTË.

– “Dija e Tij për gjendjen time, është e mjaftueshme që unë të mos i kërkoj gjë!”, përgjigjet i madhi Ibrahim! Pra, All-llahu (xh.sh.) e di se ku ndodhem, dhe përse ndodhem. Zoti e di se unë jam në këtë situatë, për shkak të besimit. Nëse Zoti do që unë të digjem, le të digjem, e nëse Zoti do të më shpëtojë, ka për të më shpëtuar! Bindje e palëkundur!

Dhe All-llahu (xh.sh.) e shpëton Ibrahimin (a.s.) në një formë të mrekullueshme. Zoti i gjithësisë që i ka dhënë çdo gjëje një natyrë të caktuar në këtë botë, i ka dhënë zjarrit natyrën e djegies, temperaturën e lartë! E heq sekretin dhe i thotë zjarrit: “Bëhu i freskët dhe i paqetë për Ibrahimin!”. Dhe ai zotni (a.s.) bie në zjarr, sikur të bie në një lëndinë. Aspak panik, përpara një sprove të jashtëzakonshme.

Hz. Pejgamberi jonë (a.s.)! Në një moment kur po ndiqej së bashku me Hz. Ebu Bekrin, po shkonin nga Meka në Medinë, (në historinë e famshme të hixhretit), dhe kishin hyrë në një shpellë të vogël për t’u mbrojtur nga ata që po i ndiqnin.

Hz. Ebu Bekri filloi të dridhej nga frika për pejgamberin (a.s.)... I thotë pejgamberit (a.s.): “Pasha All-llahun, po të shikonte ndonjëri prej tyre poshtë këmbëve të tij, do të na kishte diktuar.”...

Në atë moment, të asaj sprove të madhe, ku zemra të del nga vendi, i Dërguari (a.s.) me një buzëqeshje të natyrshme i drejtohet Hz. Ebu Bekrit: “Çfarë mendimi ke për dy, i treti i të cilëve është All-llahu? Mos u dëshpëro se All-llahu është me ne!”.

Një besimtar që i kupton drejtë këto mesazhe, i përvetëson në jetën e tij të përditshme dhe merr si urë lidhëse, ndërmjet këtyre shembujve dhe realitetit të tij, ajetin kur’anor: “Me përmendjen e All-llahut, zemrat qetësohen!”. Është përherë i lidhur me përmendjen e All-llahut (xh.sh.)! Është gjithnjë në kontakt me Zotin e tij, nëpërmjet namazit, leximit

të kur’anit, mexhlise ve të dhikrit, lutjes. Ai njeri veçse imunizohet, rrethohet me dritë, saqë sfidon me dritën e tij edhe diellin! Se është drita e besimit! E, atë njeri s’ka sprovë që ta lëkundë nga të qëndruarit i fortë dhe shumë i qetë përballë sprovave!

Gazetari: Ndërkohë, Myftinia e Shkodrës me strukturat e saj ka bërë një punë mjaft të madhe në ndihmë të shumë familjeve që kanë qenë në nevojë. E them këtë edhe prej falënderimeve të shumta, që gëzojnë pjesën më të madhe të mesazheve, që kanë ardhur deri tani. Ajo që përceptoj vetë, edhe prej këtyre mesazheve, është se nuk ka qenë një punë e pakët.

Myftiu: Fillimisht, ne duhet të falënderojmë në mënyrë të pashmangshme të gjithë qytetarët e Shkodrës që e kanë mirëkuptuar situatën, prezencën e Myftinisë së Shkodrës, si dhe kemi qenë në një bashkëveprim të shëndoshë me njëri-tjetrin për të kaluar së bashku, me sa kemi pasur mundësi këtë periudhë të vështirë.

Pastaj, duhet të falënderojmë patjetër Policinë e Shkodrës, institucionet e ndryshme, si: Prefekturën, Bashkinë, veçanërisht mediat lokale dhe përtej tyre, që ishin pjesë e pandarë organizimeve tona.

Ajo çfarë kanë ofruar mediat tona lokale gjatë gjithë ditës, sidomos për besimtarët, ka qenë e papërshkrueshme për nga ndjenja e përgjegjësisë, humanizmit, besimit e shpresës! Për këtë duhet të përgëzojmë drejtuesit e mediave; presidentët e tyre, të gjithë operatorët, gazetarët e terrenit e ata në studio, si dhe krejt njerëzit që kanë bashkëpunuar në këtë drejtim. Është shumë më e madhe se ndihma materiale që mund të kenë ofruar komunitetet fetare, fondacionet, apo shoqatat bamirëse. Se, ushqimi i shpirtit dhe ngrohtësia që ka dalur nga mediat tona, duhet vlerësuar me të madhe! Është një punë jashtëzakonisht e mirë, një kontribut shumë i madh!

Nga ana tjetër, ne patjetër që duhet të falënderojmë të gjithë bashkëpunëtorët tanë, dhe të gjithë partnerët e mirë brenda dhe jashtë vendit, të cilët kanë kontribuar për Myftininë e Shkodrës, për t’i ardhur në ndihmë njerëzve në fatkeqësitë e tyre; edhe në periudhën e tërmeteve, edhe në këtë situatë e në vazhdim.

Dua të falënderoj në krye të herës, xhaminë e Buharës në Sulgen të Zvicrës, Bashkësinë Islame të Wilit në Zvicër, Bashkësinë Islame Shqiptare në Sidnej të Australisë, Bashkësinë Islame Shqiptare

në Vjenë të Austrisë dhe në veçanti Ambasadën e Shtetit të Kuvajtit në vendin tonë.

Dua të falënderoj patjetër shumë e shumë bamirës dhe shoqata të ndryshme në vendin tonë, si: “Mirësia”, “Instanbul”, “Mirënjohja”, etj.

Gjithashtu, duhet të vlerësojmë kontributin e shumë besimtarëve të përkushtuar muslimanë shqiptarë, në Zvicër, Kanada, Australi, Gjermani, Itali, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, etj., të cilët e kanë ndarë zekatin e tyre, kanë dërguar sadeka të ndryshme për t’i menaxhuar Myftinia e Shkodrës në këtë situatë, duke kërkuar që të ngelen anonimë. Ne normalisht i kemi falënderuar gjithsecilin, edhe pse shumë prej tyre nuk kanë dashur t’i përmendet fare emri.

Kjo është madhështia e besimit dhe fetarizmit të shoqëruar me humanizëm dhe dashamirësi për tjetrin, pa e njohur dhe shpeshherë, pa kërkuar asgjë përtej dëshirës dhe nijetit të sinqertë për të ndihmuar e bërë mirë!

Këtë persona, jashtë dhe brenda vendit tonë, kanë dhënë kontribute të shumta, kanë ndihmuar me mijëra familje! Falënderoj shumë prej biznesmenëve, vëllezërve tanë muslimanë të Shkodrës, që kanë ndihmuar pafundësisht nëpërmjet programeve të Myftinisë së Shkodrës.

Shpesh e them, se format e dhënies së sadakasë, janë të shumëllojshme. Dikush nuk do që të bëhet publik, dikush dëshiron që t’i përmendet emri. Të dy rastet janë të mirëpritura dhe të dy duhen promovuar! Pra, duhet të promovojmë edhe të dhënurit e sadakasë dhe t’ia lëmë Zotit (xh.sh.) shpërblimin e saj, por edhe reklamimin e bamirësisë. Disa mendojnë se reklamimi i këtyre veprave humanitare është diçka e keqe. Jo, nuk është e keqe, përkundrazi! Është shumë me vlerë të reklamohet bamirësia, sepse ndoshta një lajm që ne japim, bëhet shkak që dikush të thotë: “Ah, edhe ju ndihmoni? Edhe ju këtu në Shkodër paskeni nevojë? A mund t’a jap edhe unë sadakanë time?”. Dhe kjo ka ndodhur sa e sa herë!

Kjo ka qenë një mirësi shumë e madhe, me të cilën jemi përballur dhe jemi përpjekur që me shumë korrektësi dhe transparencë të bëjmë shpërndarjen e çdo gjëje që ka ardhur për të mbërritur tek të zotët. Në këtë kontekst, ne jemi shumë të gëzuar, se falë këtyre kontributeve, dhe këtyre organizimeve, janë ndihmuar mbi 1000 familje në nevojë në zonën tonë.

Ndoshta janë pak, ndoshta nuk janë pak, por unë jam shumë i bindur, se ata që kanë përfutur nga këto mirësi të besimtarëve, natyrshëm që janë ndihmuar për kaluar një sprovë aspak të lehtë. D.m.th, ka qenë një ndihmë sado e vogël në sprovën e madhe të komunitetit tonë.

Natyrshëm që ne kemi një bashkëpunim thuajse të përhershëm e tradicional me disa prej shoqatave që ndihmojnë njerëz në nevojë në qytetin tonë. Janë shoqata, me të cilat kemi bashkëpunuar për të ndihmuar sadopak komunitetet njerëzish, që shpesh edhe harrohen, por që duhen mbajtur në vëmendje dhe ndihmuar me sa të jetë e mundur.

Mendoj se ka qenë një periudhë shumë e mirë në këtë drejtim. Për këtë duhet falënderuar patjetër edhe organizimi shumë i mirë i djemve tonë në stafin e Myftinisë së Shkodrës, të cilët kanë punuar pa orare dhe pa limite në këtë drejtim. Në çdo moment të ditës, edhe duke qenë agjërueshëm, edhe në diell, edhe në shi. Për këtë jam shumë i gëzuar dhe razi me punën e tyre, me kontributin e tyre, elhamdulillah!

Gazetari: Ndërkohë i nderuar Myfti, e mbyllim këtë pjesë, e cila kishte lidhje me kontributin e myftinisë gjatë kësaj periudhe karantine, megjithëse kemi akoma mesazhe që kërkojnë të dijnë nëse vendimi për kufizimin e besimtarëve me objektet e kultit, në mendimin tuaj është i drejtë apo jo?

Myftiu: Shikoni, ajo tashmë ka ndodhur dhe ka kaluar, dhe e mira është që të mos ndalemi shumë tek kjo pikë në fakt. I falënderoj ata që pyesin, se kjo më konfirmon atë që kam shkruar me datën 3 maj 2020, se është krejt e natyrshme që njerëzit të kërkojnë hapjen e xhamive, mendime për të cilat nuk jam penduar që i kam shkruar. Përkundrazi, kam qenë dhe jam shumë i bindur, se ajo çfarë ne kemi dëgjuar në mënyrë të vazhdueshme nga njerëzit, që kërkonin të paktën në 10-ditëshin e fundit të Ramazanit, t’i ktheheshim xhamisë në mënyrë të paprekur prej këtij përkufizimi që është bërë.

Më vërteton lidhjen që njerëzit kanë me xhaminë, me vendadhurimet e tyre dhe kjo është një thirrje e shpirtit, një thirrje e natyrshme. Unë kam ndjekur me çudi të madhe, dhe jam i habitur, se përse duhet vënë në diskutim një kërkesë e kujtdo qoftë prej besimtarëve, nga lindja në perëndim, nga një cep në një cep tjetër të botës, që kanë bërë statuse, analiza, edhe kritika të shumta (shpesh të drejta dhe me vend) për mos hapjen

siç duhet të objekteve të adhurimit.

Edhe unë e kam bërë një pyetje të tillë, sikurse kam parë me një habi shumë të madhe reagimin e dikujt prej njerëzve të qeverisë sonë, që asokohe nuk kishte përgjigje për masat që duhet të kishte marrë qeveria, për hapjen e vendadhurimeve..!?

Kjo nuk është normale. Ne nuk jetojmë në shpella, në vende të izoluar nga qytetërimet! Si qenka kjo që, një përfaqësues, dikushi nga qeveria të thotë nuk e kemi studiuar atë..?! Si nuk e keni studiuar atë, po çfarë keni studiuar?! D.m.th, mund të hapen shumë vende të tjera, edhe vendet e alkoolit, duke qenë edhe në muajin e madhërueshëm i Ramazanit, dhe kjo normalisht është një shkelje etike, e moralit, e normave të qytetarisë, dhe te vlerave tona kombëtare, sidomos në momente të shenjta të vitit, siç është muaji i madhërueshëm i Ramazanit në këtë kontekst!

Por, kjo ka kaluar tashmë, dhe ne kemi folur e reaguam në kohën e duhur. Por, unë patjetër duhet të falënderoj me të madhe të gjithë ata qytetarë të nderuar të vendit tonë, dhe jashtë këtij vendi që i ka qarë zemra për xhamitë, për disa masa shumë të ekzagjeruara në raport me kontekstin e besimit dhe frekuentimit të objekteve fetare. Ajo ka kaluar dhe shpresojmë që të mos përsëritet më dhe ta tejkalojmë këtë prag në të cilin jemi dhe të rikthehet normaliteti në xhamitë tona, në jetën tonë të përditshme.

Gazetari: Z. Sytari, ju përmendët pak më përpara, “duke superuar vlerat tona kombëtare...”, por shpeshherë dalin opinione që feja i tejkalon, i fshin identitetet kombëtare.

Myftiu: Jo, nuk është e saktë dhe nuk qëndron kjo, si mundet feja t’a tejkalojë këtë?! Këto lloj konstatimesh vijnë zakonisht nga mungesa e leximit, nga pa dija, edhe nga mosreflektimi i asaj që lexojmë në Kur’anin Famëlartë dhe në traditat e Hz. Muhammedit (a.s.)! Sa e sa herë përmendet në Kur’anin Famëlartë kombi? Vetë fjala komb, është fjalë arabe, terminologji kur’anore. Koum: popull, komb!

All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur’an: “O ju njerëz, Ne ju kemi krijuar nga një femër dhe nga një mashkull, ju kemi bërë popuj dhe fise, që të njiheni me njëri-tjetrin.”. Që do thotë, të njiheni nëpërmjet identiteteve tuaja, përfshi edhe atë kombëtar. Një shqiptar, me një sherkez, fjala bie. Një italian, me një saudit. Janë kombësi ato, Zoti (xh.sh.) na ka falur të tillë. Ne flasim këtë gjuhë, kjo

është gjuha jonë kombëtare, çfarë lidhje ka feja me gjuhën time kombëtare?!

Përkundrazi, ne kemi studiuar në historinë tonë islame, se në të shkuarën, përherë janë respektuar kombësitë, ndjesitë kombëtare, ndjesitë etnike, njësoj edhe ndjesitë fetare. Kështu ka qenë qysh në kohën e Pejgamberit (a.s.), dhe kështu ka për të qenë deri në ditën e fundit.

Kur ishim studentë në Damask, aty ishin mbi 50 kombësi dhe asnjëherë nuk kemi pasur problem e konflikte. Asnjëherë nuk na kanë diferencuar a parë me syrin e prejardhjes! Madje, kur vinte Bajrami, na kërkonin që brenda mundësive të visheshim me veshjet tona kombëtare për të marrë pjesë në pritjen e madhe që zhvillonte Kryemyftiu i Sirisë, rahmet pastë!

T'ju jap një shembull tjetër. Pejgamberi (a.s.) thotë: “Unë jam më elokuenti i arabëve”, pra në kombësinë e arabëve, nuk ka thënë më elokuenti i muslimanëve, ka përmendur kombësinë e tij arabe, nëse vlen të themi kështu.

Një shprehje tjetër e Pejgamberit tonë (a.s.), thotë: “Duajini arabët, se unë jam arab!”. Pavarësisht studimit të transmetimit të zinxhirit të këtij hadithi, kjo fjalë është një dëshmi shumë e madhe në këtë kontekst.

Ne lexojmë në historinë tonë islame emra të mëdhenj e të shquar, si: Selman El-Farisi, Selman persi. Është përmendur emri dhe identiteti i tij i prejardhjes etnike në prani të Pejgamberit (a.s.), pa asnjë lloj kompleks.

Pse është përmendur dhe përmendet akoma sot, prejardhja etnike e sahabiut Suhejb Rumiut, me prejardhje romake? Është normale, nuk ka asgjë për të diskutuar këtu! Hz. Suhejbi ishte njëri prej shokëve dhe krahëve të fortë të Pejgamberit (a.s.).

Pse është përmendur dhe vlerësuar sa nuk është vlerësuar njëri në historinë islame, në të gjallë të Pejgamberit (a.s.) edhe deri sa ka ndërruar jetë, Hz. Bilal Habeshiu? Bilal etiopiani, është një sahabi i nderuar, muezini personal i Resulull-llahut tonë (a.s.), më i miri dhe më i dashuri muezin për çdo musliman deri në ditën e fundit. Ai ishte me prejardhje habeshite, pra etiopian, toka e Habeshesë, a Abisinisë, ngjitur me Sudanin. Pra, ka qenë i zi për nga ngjyra e trupit, nuk ka qenë as esmer, as nuk ka qenë i bardhë.

Tek ne nuk ka racizëm, nuk ka kështu dallimesh, dhe për të dëshmuar se Islami i sheh njerëzit të gjithë të barabartë! Për

KY ËSHTË SHPIRTI I BESIMIT DHE SHPIRTI I VLERAVE, FRYMË QË NE DUHET T'A THEMI, E T'A PËRHAPIM SA MË SHUMË. DUHET TË EDUKOJMË FËMIJËT TANË ME TË MADHE ME KËTË SHPIRT KOMUNIKIMI NË MESIN TONË!

këtë, në ditën më të rëndësishme të tij, ditën e çlirimit të Mekës, Hz. Muhammedi (a.s.) urdhëroi Hz. Bilal Habeshiun, etiopianin, zezakun, të ngjitej në majë të Qabes dhe këndonte ezanin! Këmba e zezakut ka shkelur mbi Qaben tonë të shenjtë me urdhër të Pejgamberit tonë (a.s.)!

Kjo është madhështia e fesë islame!

Ata që thonë, feja e kombi, kështu e ashtu, natyrshëm që e kanë nga mungesa e leximit dhe mungesa e trajtimit të këtyre çështjeve shumë të rëndësishme nga pikëpamja fetare, islame!

Gazetari: Në fakt z. Sytari, unë zgjodha një mesazh, si më i veçantë se të tjerët, dhe e falënderoj dërguesin e tij. **“I nderuar z. Sytari, ju ndjek me kënaqësi edhe pse i takoj një besimi tjetër, ashtu siç e keni përmendur edhe ju, ne duhet t’a respektojmë dinjitetin e njëri-tjetrit për hir të besimit në një Zot, por edhe prej origjinës dhe bashkëqytetarisë që kemi, për më tepër në rastin e Shkodrës, unë mendoj se jemi pasuria e njëri-tjetrit.”** Dhe me të vërtetë këto fjalë më kanë tërhequr shumë.

Myftiu: Ky është mesazhi më i bukur që mund të kem marrë prej shumë kohësh, në pozitën e thirrësit islam! Atë person që e ka shkruar këtë mesazh, e falënderoj shumë dhe e përshëndes me zemër!

Në fakt, ky është një mesazh që del nga zemra e shpirti e një njeriu të mirë, një besimtar të mirë, një qytetari të mirë! Ne përherë lutemi që Zoti ta begatojë vendin tonë, dhe njerëzimin mbarë, dhe të na udhëzojë drejt të jetuarit në paqe e në harmoni me njëri-tjetrin, duke respektuar njëri-tjetrin, vlerat e njëri-tjetrit.

Ashtu sikurse na thotë Zoti në Kur’an, të njihemi me njëri-tjetrin, sepse ashtu siç kam unë vlera, edhe ju keni vlera, siç ka zotnia vlera, ka dhe dikush tjetër

vlera. Padyshim ai është përshkrimi më i bukur, që “ne jemi pasuria e njëri-tjetrit”.

Unë e them në ligjëratat e mia, në librat e mi dhe në daljet e mia publike, se Zoti ka dashur që të jetojmë me diversitete në këtë jetë. Ata që dinë të vlerësojnë dhe të respektojnë normat dhe vlerat e diversitetit, jetojnë si mbretër! Njëkohësisht, ata shijojnë pasuritë e njëri-tjetrit. Në këto kontekste, ajo që është e imja, është edhe e zotërisë, dhe ajo që është e zotnisë është edhe e imja dhe e shenjtë tek unë dhe anasjelltas.

Në fakt ky është shpirti i besimit dhe shpirti i vlerave, frymë që ne duhet t’a themi, e t’a përhapim sa më shumë. Duhet të edukojmë fëmijët tanë me të madhe me këtë shpirt komunikimi në mesin tonë! E kemi për detyrë, edhe si komunitete fetare, të bashkëpunojmë fort, që lënda e edukatës fetare të kthehet në kurrikulat e arsimit shqiptar.

Se ka nevojë fëmija i sotëm, rinia e nesërme dhe rinia e sotme për edukatën fetare, atë edukatë që e bën njeriun të jetojë me dinjitet, si vëlla i njeriut, pa paragjykime, pa hile. Pa paragjykimin e fesë, racës, kombësisë, gjendjes sociale, etj., sepse në finale, siç thotë edhe Hz. Muhamedi (a.s.): “Njerëzit janë të barabartë si, dhëmbëzat e krehërit”, dhe se tek Zoti i gjithësisë, peshorja nuk është peshorja e arsytimeve e mendësive tona të ngushta, fanatizmave të sëmura, shpesh të verbra e të çekuilibruara, por peshohemi mbi bazën e devotshmërisë.

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Devotshmëria është këtu!”, dhe e ka përsëritur tre herë këtë, si për të na thënë, nguliteni në mendje këtë, se kjo nuk është çështje në dorën tuaj, por është çështje në dorën e Zotit, dhe lidhet direkt me zemrën. Zemrën nuk e komandon askush përveç Zotit të gjithësisë!

Gazetari: Në fakt duhej ta ruaja për fund, por nuk rezistova pa e lexuar këtë mesazh. Ajo çfarë ka rënë në sy gjatë kësaj periudhe, z. Sytari, ka qenë që edhe njerëzit e politikës shpeshherë u janë referuar librave të shenjtë, për t’ju drejtuar qytetarëve, duke filluar prej presidentit, kryeministrit, e shumë politikanë të tjerë. Këtë e shifni reflektim, apo prej trilleve të politikës?

Myftiu: Si fillim, shumë mirë kanë bërë! D.m.th, ngjyresa fetare në ligjërimet tona, natyrshëm që na e zbukuron komunikimin e performancën. Mirëpo duhet të kemi parasysh se kur bëhet fjalë për fenë dhe për ngjyresën fetare, kthehemi përherë tek zemra. Nijetin e di vetëm Zoti. All-llahu (xh.sh.) ka shpallur një sure në Kur’an, e cila quhet surja e munafikëve, e hipokritëve, Zoti na ruajt

me qenë prej tyre!

Munafikët e Medines vijnë tek i Dërguari (a.s.) dhe i thonë: “Ne dëshmojmë se ti je i Dërguari i All-llahut!”. All-llahu i Madhëruar shpall: “All-llahu e di se ti je i Dërguari i Tij. All-llahu dëshmon se munafikët janë gënjeshtarë!”. Si gënjeshtarë? D.m.th në nijetin e tyre, në zemrën e tyre të sëmurë!

Kjo është në përgjithësi, ka të bëjë me të gjithë ne, një sure që duhet ta lexojmë të gjithë; unë i pari, të gjithë pa përjashtim! Unë kur shoh se presidenti, kryeministri, a dikush me ndikim dhe me pushtet në vend i referohet Kur’anit, një thënieje kur’anore, një verseti biblik, një hadithi të pejgamberit (a.s.), një urtësie të spikatur e me dobi të një personaliteti të shquar të fesë, natyrshëm që ajo është diçka e dobishme, diçka me vlerë, por jo sa për t’u bërë lajm! Unë them shumë mirë bën ai që e përdor këtë pasuri shekullore në ligjërimin e tij, pastaj nijeti është çështje mes robit dhe Zotit!

Unë kur ju them njerëzve, se jo çdo gjë që e dëgjoni, qoftë edhe prej nesh, duke filluar tek unë i pari, myftiu i juaj, mos e pranoni në mënyrë shabllone! Pyesni dhe siteni mirë mendimin dhe argumentin! Dëgjove një ajet kur’anor, një hadith të pejgamberit (a.s.), një konstatim, një dëshmi të vjetër, etj., mos e merr atë në mënyrë të verbër dhe mos u ngut të japësh gjykimin e menjëhershëm! Peshoje fillimisht me mendjen tënde, arsyeto, përdore logjikën, reflekto dhe pyet, pyet pa fund!

Kur këtë e them për veten time natyrshëm që pas meje vijnë edhe të gjithë ata që flasin apo i referohen Kur’anit, apo hadithit të Pejgamberit (a.s.), që të jem shumë i sinqertë!

Gazetari: Në ligjëratat tuaja që keni mbajtur gjatë gjithë muajit të Ramazanit, sikurse edhe në ligjëratën e mbajtur pak ditë më përpara për ditën e xhuma, gjithnjë mundoheni që fenë ta shikoni si një zbatim në jetën e përditshme sesa thjesht një ftesë për adhurim.

Myftiu: I dashur, unë mendoj se krejt mënyra e komunikimit tonë me besimtarët, ligjërimi rutinë, (në qoftë se vlen të thuhet kështu), ka nevojë për t’u rishikuar. Unë ia them edhe imamëve, në takimet e ndryshme që kemi, e diskutoj edhe me kolegët e mi, brenda vendit por edhe jashtë, e diskutojmë edhe në workshope dhe komunikime të ndryshme që kemi, që ka nevojë për t’u shikuar, se çfarë po ju themi njerëzve!

Drejt çfarë fryme po i marrim njerëzit? A do të flasim me njerëzit dhe

të trajtojmë fenë si një çështje shumë e ngushtë në një qoshk të përditshmërisë sonë, apo do t’i japim fesë, vendin që i ka dhënë Zoti në Kur’anin Famëllartë dhe Pejgamberi (a.s.) në praktikën e tij të përditshme?

Feja është krejtësisht e pavlefshme nëse ngelet në kufijtë e një marrëdhënieje shumë të ngushtë të njeriut, dhe që nuk reflektohet në jetën e tij të përditshme. Çfarë kuptimi do të kishte atëherë të themi se: “Nuk ka besuar dikush që fle i ngopur, teksa komshiu i tij është i uritur, dhe ai e di këtë!”, që është një ndër bazat e ruajtjes së marrëdhënieve të forta e të sinqerta me komshiun, në fjalët e Resulull-llahut (a.s.)?! Unë falem në xhami, bëj dhikër, lexoj Kur’an, po çfarë më duhet komshiu? Pejgamberi thotë jo, përkundrazi, fetarizmi i jot real nis pikërisht, kur të dalësh nga xhamia e të jesh musliman me komshiun tënd!

Çfarë vlere ka të themi hadithin e Resulull-llahut (a.s.): “Nuk ka arritur asnjëri prej jush në plotësinë e besimit, ai që komshiu i tij nuk ka garanci ndaj të keqes së tij!”? Vlera e tij qëndron pikërisht tek domosdoshmëria që të tjerët ta shohin dhe ta lexojnë Islamin tonë në vepra konkrete, jo në fjalë, a në lëvizjet tona mekanike në xhami!

Çfarë kuptimi do të kishte leximi i hadithit se një grua, që lutej, adhuronte e falej, porse merrte hallkun nëpër gojë dhe lëndonte të tjerët me fjalët e saj; kur Resulull-llahu (a.s.) u pyet për të, tha: “Ajo është në zjarr!”. Do të thotë: O muslimanë, kontrolloni gjuhët tuaja, mos t’ju gënjejë veprimi mekanik i adhurimeve, pa kuptuar e ndërë thellë qëllimin dhe vlerën e tyre!

Të lexojmë hadithin e Pejgamberit (a.s.) që një grua, u ndëshkua tek Zoti i saj, sepse izoloi një mace të gjorë. As nuk i jepte për të ngrënë, as nuk e lejonte të hante prej mbeturinave jashtë, derisa ajo ngordhi.

Atëherë çfarë është ky Islam, që respekton deri të drejtat e kafshëve? Çfarë është kjo fé, në të cilën mësojmë se Pejgamberi (a.s.) thotë: “Edhe një zog që fluturon, që vritet pa të drejtë, do të pyetet dhe do t’i jepet e drejta të kërkojë hakun e tij në ditën e gjykimit para duarve të Zotit!”? Çfarë është kjo fé, i dashur? Është feja që jemi urdhëruar dhe urdhërohemi që ta jetojmë në jetën tonë të përditshme, që të dëshmohemi si besimtarë në çdo sferë të jetës, duke qenë vepërmirë, fjalëmirë, të moralshëm, të sinqertë, larg gënjeshtres, korrupsionit, intrigës, hilesë! Pra, jemi ftuar për të qenë njerëz me besim të

pastër në zemër, dhe me frikën e Zotit në jetë!

Përndryshe, do të jetojmë në një anarshi të madhe, siç jeton njeriu i kësaj periudhe, që ka nevojë të menjëhershme për t’u kthyer nga dera e besimit. Sot, po na vërtetohet më tepër se asnjëherë tjetër, se lëngatat e këtij shekulli, i shëron vetëm besimi dhe të kthyerit me sinqeritet tek dera e Zotit të vërtetë të gjithësisë! Për të qenë politikan i jonë i ndershëm, mësuesi i ndërgjegjshëm për peshën e përgjegjësisë që ka para duarve, prijësi fetar largpamës dhe edukator i urtë, prindi i mëshirshëm dhe i përgjegjshëm për amanetin e shtrenjtë që ka para duarve, i riu i jonë i edukuar, rinia jonë e ditur, e moralshme, e urtë! Për të qenë njeriu, cilido njeri, mëkëmbës i denjë i Zotit në këtë jetë!

Duke folur vetëm për adhurimin, se si të shkojmë në xhami, e të ngjashme, ne e izolojmë fenë në një cep të jetës, dhe themi stop, nuk do të flasim për asgjë tjetër!?

Kemi nevojë që të dalim nga keqleximi, keqinterpretimi edhe keqpërdorimi i fees, si pasojë e padijes së mjaftueshme dhe mungesës së instrumenteve diturore dhe logjike për ta vendosur tekstin fetar në vendin e duhur në realitetet, me të cilat përballemi ne dhe mbarë njerëzimi!

Kemi nevojë ta jetojmë fenë, ta shijojmë urdhëresën dhe ndalesën, pasi ta kemi kuptuar drejtë atë! Edhe kur buzëqeshim në fytyrën e tjetrit, edhe kur themi një fjalë të mirë, edhe kur përpiqemi që ta bëjmë një punë me përpikmëri, tamam siç thotë Hz. Muhamedi (a.s.): “All-llahu do nga njeriu, që kur ta bëjë një punë, t’a përsosi atë!”.

D.m.th, ti si musliman dhe praktikant i fesë, je i thirrur nga Zoti i gjithësisë që punën, që e bën, në atë pozicion që të ka vendosur Zoti i jot në këtë jetë, ta përsosësh! A jemi ne realisht muslimanë, teksa lexojmë këto tekste dhe shumë e shumë të tjerë, që na thërrasin ta dëshmojmë si duhet fenë e All-llahut?!

Gazetari: Kemi tejkalluar çdo limit kohor dhe isha i nderuar që ju kisha në studio. Besoj se edhe pjesa më e madhe e shikuesve, të cilët i falënderoj të gjithë, i kanë marrë përgjigjet e pyetjeve të tyre...

Myftiu: Ju falënderoj dhe ju uroj të gjithëve mbarësi dhe bekim!

(Nga bashkëbisedimi i gazetarit Erzen Koperaj me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në emisionin e përjavshëm “Tonight” në Star Plus Tv – Shkodër, më 17 qershor 2020)
Përgatiti për botim: **Isra M. Sytari**

TOLERANCA ISLAME

FERMANËT SULLTANORË SI FORMA TË DHËNIES SË TË DREJTËS NDËR SHQIPTARËT

“E vërteta është që Perandoria Osmane ka njohur zyrtarisht disa prej ndryshimeve themelore të tjetrit...

Njihej ligjërisht dallimi fetar dhe autonomia e institucioneve të besimit tjetër, të krishterë. Me njohjen e ndryshimit, pranimit të tij, fillon toleranca.

Toleranca ka shkallë të tjera. Një prej tyre do të shprehej në pyetjen njohja e ndryshimit a ishte vërtetë dhe shprehje e ndryshimit dhe barazisë në ndryshim?

Kësaj pyetje nuk mund t'i jepet një përgjigje pasuese e katërciptë, po ashtu dhe mohuese. Në koleksionin e fermaneve të Shqipërisë ka me dhjetra dekrete që mbrojnë pasuritë e të krishterëve. E shohim në fermanin e sulltanit të vitit 1699 që i drejtohet priftit dhe kadiut të Delvinës mbi marrjen e masave ndaj personave që ndërhyjnë në pronat e kishës së Delvinës...

Kjo tolerancë fetare brenda këtyre fermaneve nuk shprehet vetëm në raportet e vendosura me klerin ortodoks po dhe atë katolik.

Në mjaft fermanë flitet për urdhëra të lëshuar për ndërtim kishash katolike në qytete të ndryshme, si Durrës, Prevezë, Shkodër, etj.

Me mjaft interes është korrespondenca e sulltanit me ipeshkëvin e Shkodrës për ndërtim manastiri në Shkodër, për ndërtimin e katedrales, për ngritjen e një instituti françeskan po në këtë qytet.

Është për t'u çuditur se korrespondenca është bërë në dy gjuhë, atë osmane dhe italiane.”

- **Prof. Dr. Kallopi Naska**, “*Fermanët sulltanorë si forma të dhënies së të drejtës ndër shqiptarët*”, botuar në përmbledhjen me titull: “*Nga Perandoria Osmane në Shqipëri e shkruam historinë me tolerancë...*”, botim i TIKa, Tiranë, 2005, f. 38-39.

BASHKËJETESA NDËRFETARE MIDIS SHQIPTARËVE

“Bashkëjetesa ndër fetare ka shoqëruar procesin e përhapjes shkallë-shkallë të islamizimit në mesin e shqiptarëve.

Kalimi jo në masë dhe jo i menjëhershëm i shqiptarëve në besimin e ri flet në të mirë të tezës, se ky kalim është bërë pa dhunë të drejtpërdrejtë. Madje, anëtarët e një familjeje nuk kalonin njëherësh në fenë islame.

...

Aristidh Kolja, autori i mirënjohur i librit “Arvanitët” (Athinë, 1986) thekson, me të drejtë, që nuk ka ekzistuar asnjë rast i kthimit të fesë me dhunë nga ana e turqve. Këtë ai e konsideron “një gënjeshtëri qëllimkeqe”. Më tej ai ngul këmbë që “Ndërrimi i fesë së shqiptarëve me dhunë është pjellë e fantazisë dhe shpikje e murgjëve dhe nuk është aspak e hijshme që ta pretendojnë këtë historianët”.

...

Dëshmitarë të huaj japin të dhëna interesante lidhur me ceremonitë fetare, të cilat zhvilloheshin në të njëjtin vend, si për myslimanët ashtu edhe për të krishterët. Ende në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, ishte bërë zakoni që i njëjti lokal, të premten të shërbente si xhami, kurse ditën e djelë përdorej si kishë.

Familjet e pasura myslimane vinin në dispozicion shtëpinë e tyre për zhvillimin e meshës.

...

Islamizimi me tolerancën e vet të pranuar shkencërisht, u përhap gjërësisht në mesin e shqiptarëve...

...

Nuk duhet harruar që të gjitha format e bashkëjetesës ndër fetare në mesin e shqiptarëve kanë mbijetuar dhe mund të thuhet edhe kanë lulëzuar gjatë shekujve të pushtetit osman.

Teza kuranike se Zoti nuk është vetëm i myslimanëve (rab yl myslimin), por i të gjithë njerëzimit (rab yl alemin) gjente zbatim të gjerë në praktikën osmane.

Intoleranca fetare midis shqiptarëve nuk zuri vend edhe pse nuk munguan forca të interesuara për nxitje në këtë drejtim...”

- **Prof. Dr. Gazmend Shpuza**, “*Bashkëjetesa ndër fetare midis shqiptarëve*”, në përmbledhjen: “*Nga Perandoria Osmane në Shqipëri e shkruam historinë me tolerancë*”, botim i TIKa, Tiranë, 2005, f. 41-46.

ZIMITËT (1)

Gjatë periudhës së inkorporimit të një shteti në territorin islam, jomuslimanët mund të shkonin kudo që dëshironin, ose të nënshkruanin një kontratë me shtetin islam dhe të vazhdonin të jetonin atje duke respektuar kushtet e kontratës. Kjo kontratë ndërmjet shtetit islam dhe jomuslimanëve quhej ‘zimmet’ dhe jomuslimanët, të cilët e nënshkruanin kontratën ‘zimmi’.

Sipas saj, zimmëtët pranonin në thelb të zbatonin rregullat e ligjit islam dhe në këmbim të mosangazhimit në shërbimin ushtarak, paguanin taksën, të quajtur xhizje.

Në këmbim të saj, shteti u garantonte sigurinë e jetës dhe pronës, si dhe i lejonte të ushtronin besimet e tyre fetare. Kontrata e firmosur me zimmëtët në periudhat më të hershme gjithmonë theksonte këto kushte.

E bazuar në thëniet e Kur’anit, të sures El-Bekare (2/256), Junus (10/99) dhe në Traditën e Profetit, liria fetare dhe ajo e besimit që u akordohej jomuslimanëve, nuk shihej vetëm si liri për besimin dhe praktikën fetare, por gjithashtu si liri në të gjitha çështjet ligjore, si martesë, divorci, trashëgimia sipas ligjeve të tyre dhe si plotësim i natyrshëm i këtyre lirive.

Parimi i përgjithshëm në këtë çështje u përmbledh nga juristët, “si të ishin urdhëruar për të mos ndërhyrë në çështjet dhe në fenë e tyre”.

Kështu që, kur kalifi emevi Omer ibn Abdulaziz e pyeti dijetarin e famshëm, Hasan El-Basri, nëse shteti mund të ndërhyjë në martesat e zimmëve, të cilat konsideroheshin të paligjshme sipas ligjit islam, ai u përgjigj se nuk duhej ndërhyrë përderisa ata paguanin xhizjen në mënyrë që të jetonin sipas fesë së tyre. ... Me fjalë të tjera, u ishte dhënë autonomia ligjore.

...

Kur guvernatori i Egjiptit, Muhammed ibn Ebû Bekr pyeti se cili ligj duhej zbatuar në rast tradhëtie bashkëshortore, kur përfshihen një musliman dhe një i krishterë, Aliu u përgjigj se ligji islam duhet zbatuar tek muslimani dhe ligji i krishterë tek i krishteri... (vijon inshallah)

- “*Historia e shtetit, shoqërisë dhe*

qytetërimit osman”, botuar nga AIITC, Tiranë, 2009, vëll. 1, f. 456-458.

ZIMITËT (2)

Që nga formimi i shtetit (osman) numri i komunitetit zimmî rritej vazhdimisht, sidomos pas pushtimit të Stambollit, kështu që një numër i konsiderueshëm i këtij komuniteti ishte i pranishëm deri më rënien e shtetit osman.

...

Është bërë i njohur fakti që, pas pushtimit, shteti shqyrtonte ekskluzivisht statusin ligjor të komunitetit zimmî. Fillimisht Mehmeti i dytë emëroi Gemnadius si patriark të kishës ortodokse greke dhe ka mundësi të ketë nënshkruar një marrëveshje me të, në emër të pasuesve të tij.

...

Në të vërtetë, si kontrata me komunitetin zimmî në Gallatë dhe berati në lidhje me kryepeshkopin e periudhës së Mehmetit të dytë, tregojnë se zimmëtë ka mundësi të kenë vazhduar me aktivitetet e tyre fetare; shërbimet kishtarë, ndërkohë që pozita e zyrtarëve të kishës dhe të kryepeshkopit do të qëndronin po njësoj. Deri diku, u ndoq praktika e Perandorisë Bizantine. Është bërë e ditur, se në këtë Perandori të krishterët kishin të drejtën të drejtoheshin në gjykatat e tyre fetare për sa i përket çështjeve ligjore pas vitit 303. Më vonë, të njëjtat të drejta ligjore iu dhanë hebrenjve.

Në këtë situatë, është e mundur të mendohet se jomuslimanët po i pëlqenin privilegjet pas rënies së Perandorisë Bizantine. Kritovoulos, një historian nga epoka e Mehmetit të dytë shpjegon se të drejtat që iu dhanë patriarkut grek nga Sulltani nuk ishin më të pakta nga ato të Perandorisë Bizantine.

...

Zhvillime të ngjashme ndodhën edhe me miletin armen...

...

Si rezultat i kësaj mënyre organizimi të miletit, funksionarët drejtues të kishës arritën të qeverisnin popullin e tyre si milletbaşis. Udhëheqësit dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe fetarë ishin përgjegjës për ta në shtetin osman. Në këtë mënyrë, komunitet (xhemate) jomuslimanësh arritën të gëzojnë njëfarë autonomie. ...

...

Armenët katolikë, për shembull u organizuan si millet më vonë, më 1830. Shumica e atyre që nuk formonin

komunitet më vete përfshiheshin në atë armen dhe Patriarkana Armene kishte autoritet ligjor dhe juridik mbi ta.

Nga këndvështrimi i sistemit ligjor osman, ishte e rëndësishme që jomuslimanët të përfitonin nga autonomia juridike dhe ligjore që iu ishte dhënë. Sidoqoftë, ata u organizuan si millet dhe jetuan si komunitete (xhemate) dhe me kisha të pavarura.

- “*Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*”, botuar nga AIITC, Tiranë, 2009, vëll. 1, f. 459-461.

.....

(Shënim: Kjo është temë e gjerë dhe e mbushur me shembuj pafund, që nxjerrin në pah madhësinë e Islamit në praktikën osmane në raport me jomuslimanët. Librat e historisë janë të mbushura me këto shembuj të pasqorë në historinë e njerëzimit.)

NË FENË E TË PARËVE... (1)

“Organi i zyrës së Ipeshkvisë së Kosovës shkruante për periudhën osmane se Halifi dhe Porta e Lartë i kushtuan rëndësi të madhe tolerancës fetare, në kohën kur Evropa mesjetare ishte përgjakur në fanatizmin fetar të krishterë.

Volteri, edhe si kundërshtar i Islamit, pohonte se modeli islam i rregullimit të jetës paraqiste shembullin më të mirë të tolerancës ndërfetare.

Shumë kohë më parë Patriarku grek Michael III (1167-1177) shkruante: ‘Më parë do të pranoja një mysliman për udhërrëfyes timin në çështje të jashtme, se një latin të më dominojë në çështje të shpirtit. Sepse, nëse jam nënshtetas i myslimanit, së paku nuk do të më detyrojë të pranoj besimin e tij...’.

Duke bërë fjalë për tolerancën shqiptare në kohën e Perandorisë, Kliv Ponting vështonte: ‘Lëvizja nacionaliste shqiptare ishte e vetmja që drejtohej kundër vendeve si Mali i Zi, Serbia, Bullgaria e jo kundër osmanëve.’

Në këtë vështrim, në pyetjen e një gazetari, Thierry Fabre tha: ‘Feja myslimane u tregua shumë tolerante... myslimanët shqiptar nuk përfituan kurrë nga statusi i tyre’, se: ‘Perandoria otomane – janë Shtetet e Bashkuara të Mesjetës’ dhe se: ‘me daljen nga perandoria otomane, popujt ballkanikë u bënë shovinistë’.

Nisur nga kjo, ne duhet të pyesim veten: çka do të kishte ngjarë me shqiptarët sikur ‘pushtuesi 500-vjeçar’ të ishte cilido shtet i fqinjësisë shqiptare,

a do të flitej më gjuha shqipe në këto anë të Ballkanit? Çfarë ngjau me paraardhësit e tyre ilirë në Slloveni, Kroaci, Bosnjë, Mal të Zi, Maqedoni, Thrakë etj? Pse nuk kishte asnjë shkrim shqip para Perandorisë në këto troje? ...”.

- **Hajrudin S. Muja**, “*Në fenë e të parëve*”, LOGOS-A, Shkup, 2013, f. 33-34.

NË FENË E TË PARËVE... (2)

“Kujtesa popullore e Shkodrës na sjell fjalët e veprimtarit dhe intelektualit të Rilindjes, Mati Logoreci (1867-1941), mësues i shkollës së parë shqipe në Prizren (1888): “Ne katolikët (shqiptar) ekzistojmë në sajë të myslimanëve. Po të mos ishin myslimanët, sllavët prej kohësh do të na kishin asimiluar ose do të na kishin përzënë prej këtej.”.

Po kështu, kishte shkruar më 1900 edhe një i krishterë korçar: “S’janë vallë muslimanët shqiptar që mbajtën në këmbë gjer më sot ato zakone të të vjetërve tanë që çuditën botën..?! Të mos ishin këta ‘tradhtarë’ të fesë, si thonë ca tradhtarë të mëmëdheut, Shqipëria nuk do të ishte aq e madhe sa është sot; do të ishte përgjysmë, një e katërta, nga shkaku i Shqehvet... Myslimanët shqiptar i vunë frenë përhapjes së detit shqah... Myslimanët e sotëm janë ata që i apin Epirit karakter shqiptar.”.

Edhe Dom Nikollë Mazreku në demaskimin e demagogjisë së Cordignano’s i thoshte se: “nëpërmjet Islamit nuk është shkombëtarizuar asnjë krahinë etnike shqiptare; një meritë dhe një arritje tejet e madhe.”.

...

Qytetet dhe fshatrat kishin xhami e kisha, por asnjëra me ceremonialet dhe ritet e saja, me pamjet e angazhimet e tyre, nuk pengonin njëra-tjetrën, nuk e prishnin qetësinë për qytetarin e cilitdo besim. Kështu, në mesin e shqiptarëve zotëronte një tolerancë për çdo lëvdatë!

...

Misionarja amerikane Delfe Davis shkruante se të gjithë elementët kristianë të Manastirit, deri në vitin 1912, gëzonin liritë e plota fetare, ndërkohë që Kostandin Çerkezi shkruante se të krishterët dhe muslimanët e Shqipërisë kishin marrëdhënie shumë më të mira se katolikët dhe protestanët e Evropës së qytetëruar.”.

- **Hajrudin S. Muja**, “*Në fenë e të parëve*”, LOGOS-A, Shkup, 2013, f. 38-39.

EMIRATET E BASHKUARA ARABE

QË NJIHEN EDHE ME EMRIN THJESHTË "EMIRATET"

Emiratet e Bashkuara Arabe, që njihen edhe me emrin thjeshtë "Emiratet", janë një federatë e përbërë prej shtatë principatash: Ebu Dhabi, Dubai, Esh-Shārika, Ra's El-Khaimeh, Axhmān, Umm El Kajūn dhe El-Fuxhaira, ku Ebu Dhabi është zgjedhur kryeqytet i vendit.

Emiratet ndodhen në pjesën jug-perëndimore të kontinentit të Azisë dhe në lindje të Gadishullit Arabik. Në pjesën veriore dhe veri-perëndimore ato lagen nga ujërat e Gjirit Arabik, në jug dhe në perëndim kufizohen me Mbretërinë e Arabisë Saudite, në juglindje me Sulltanatin e Omanit dhe e kanë një rrip bregdetar edhe në Gjirin e Omanit.

Vendi në tërësi ka një sipërfaqe prej afërsisht 71.023.6 km², ku 27,624.9 km² e përbëjnë një grup ishujsh në Gjirin Persik.

Sipas Worldmeter, popullsia aktuale e Emirateve të Bashkuara Arabe është 9,886,737 banorë (qershor 2020), ku gati 87% të saj e përbëjnë të huajt.

GJUHA

Arabishtja është gjuha zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe, siç përdoren edhe gjuhë të tjera, si gjuha angleze, indiane dhe persisht.

Një pjesë e madhe e popullsisë së Emirateve janë me origjinë nga vendet e nënkontinentit Indian, si Filipinet, Irani dhe vende të tjera, prandaj atje fliten gjithashtu edhe gjuhët urdu, tagalog, malajisht, rusisht, edhe gjuhë të tjera.

KLIMA

Emiratet e Bashkuara Arabe karakterizohen nga klima shkretinore, e ngrohtë dhe me diell në dimër, kurse e nxehtë dhe e lagësht në verë. Në malet lindore të vendit, klima është më e butë dhe më pak e lagësht.

Vendi që sot njihet si Emiratet e Bashkuara Arabe, është pjesë e rajonit që historikisht njihet si Rajoni i Omanit. Para formimit të Emirateve të Bashkuara Arabe, rajoni njihet si "Komunitetet e bregdetit të Omanit".

Kjo zonë ka një histori të pandashme nga historia e rajonit përreth saj, ku përfjetoj faza të ndryshme të historisë, me luftëra edhe paqe. Në kohë paqeje, banorët e rajonit që e kishin mjaft të

zhvilluar flotën detare, ishin shumë aktivë në tregtinë me vendet e brigjeve të Oqeanit Indian, por edhe me vende të tjera më të largëta.

Gjurmët më të vjetra të pranisë njerëzore në Emirate datojnë rreth vitit 7000 p.e.s., në ishullin Dalma, i cili gjendet në Gjirin Arabik, përballë bregdetit të Emirateve.

Me shfaqjen e Perandorisë Akaemenide (persianë), zonat e bregut perëndimor të Gjirit Arabik u konsideruan pjesë e saj. Më vonë, Aleksandri i Madh

Atë kohë industria e prodhimit të anijeve u gjallërua mjaft.

Më vonë, venitja dhe dobësimi i shtetit Abasid dhe distanca e largët e bregdetit të Emirateve nga kryeqyteti i perandorisë Islame, bënë të krijohej një lloj autonomie e kësaj zone, në menaxhimin e punëve të brendshme të tyre. Atje filloi të forcohej organizimi fisnor.

Me zbulimin e rrugëve detare nga portugezët, zona e Omanit,



FLAMURI DHE HARTA - EMIRATET E BASHKUARA ARABE

e shkatërroi Perandorinë Akaemenide, por me rënien dhe ndarjen e Perandorisë Maqedonase, brigjet e vendit u bënë pjesë e Perandorisë Sasanide (persiane) dhe vazhduan të mbeten të tilla deri në ardhjen e Islamit.

EPOKA ISLAME NË EMIRATE

Fiset e rajonit të Emirateve hynë në Islam që nga koha e Profetit Muhammed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!

Profeti (a.s), e kishte deleguar Amru ibnul-As dhe El- Ala' ibn El-Hadramij, për përhapjen e thirrjes Islame në viset lindore të Gadishullit Arabik, duke filluar nga Omani e Sohari, e deri në Bahrejn.

Pasi zona e Bahrejnit dhe qendra e rajonit të Omanit hynë në Islam në mënyrë paqësore, edhe banorët e zonës së Emirateve, që gjenden mes këtyre dy rajoneve, ndoqën të njëjtën rrugë.

Gjatë epokës së Kalifatit Emevit (Umejad), brigjet e Emirateve lulëzuan, pasi përfaqësonin rrugë të rëndësishme ujore për navigacion dhe tregti detare.

përfshirë edhe zonën e Emirateve, ranë nën influencën e portugezëve. Pas portugezëve, atje erdhën Britanikët, të cilët i bënë ato zona protektorat të tyre.

KRIJIMI I EMIRATEVE

Në vitin 1968, Mbretëria e Bashkuar deklaroi dëshirën e saj për t'u tërhequr nga të gjitha protektoratet dhe kolonitë e saj në Lindjen e Mesme. Kjo bëri që me 18 shkurt të vitit 1968, Shejh Zâjid ibn Sultân Âl Nehjân dhe shejh Râshid ibn Saïd Âl Mektûm, të mbanin një takim, ku do të kristalizohet idenë e bashkimit. Këta të dy ia drejtuan ftesën për takim të shtatë emirateve, gjithashtu ftuan edhe secilin nga emiratet e Katarit dhe të Bahreinit.

Ata do të mbledheshin në Dubai, për të diskutuar çështjen e bashkimit në një shtet të vetëm. Mbledhja rezultoi në miratimin e unionit dhe formimin e një komiteti për të studiuar kushtetutën që do të rregullonte mekanizmin qeverisës të vendit dhe administrimin e tij. Por, Katari dhe Bahreini u tërhoqën nga projekti.



Shejh Zâjid ibn Sultân Âl Nehjân dhe shejh Râshid ibn Saïd Âl Mektûm, ranë dakord ta çonin përpara projektin e federatës dhe urdhëruan Udej El-Bitâr (një këshilltar ligjor në qeverinë e Dubait), të shkruante një projekt-kushtetutë për shtetin e ri që do të formohej. Bashkimi i Emirateve u miratua në 1 dhjetor 1971 dhe të nesërmen u deklarua shpallja e pavarësisë së shtetit, nën emrin "Emiratet e Bashkuara Arabe", në Pallatin e Mikpritjes në Dubai.

Emirati Ra's El Khajme, në fillim e refuzoi projektin e unifikimit, por më pas u kthye dhe u bashkua me ta, me datën 10 shkurt, të vitit 1972.

Disa nga arsyt kryesore që çuan në krijimin e këtij shteti, janë se banorët e këtyre emirateve kishin lidhje të ngushta mes tyre, pasi të gjithë ishin bijë shaxhallarësh dhe dajash mes vete, e gjithashtu kishin të përbashkëta edhe fenë, kulturën, historinë, zakonet, traditat, edhe ekonominë.

Një arsye tjetër e fuqishme që i shtyu të bashkoheshin këto emirate ishte edhe nevoja e këtyre rajoneve për siguri dhe stabilitet ushtarak, politik, dhe ekonomik, gjë e cila do të ishte e pamundur duke qenë të ndarë. Për të arritur këto objektiva, këto emirate u bashkuan dhe formuan një shtet të unifikuar, i cili dëshmoi të ishte i suksesshëm.

Shejh Zâjid ibn Sultân Âl Nehjân, ka qenë presidenti i parë i shtetit të

Emirateve të Bashkuara Arabe dhe konsiderohet themeluesi i këtij shteti. Shejh Zâjid e mori presidencën që nga themelimi zyrtar i Federatës së Emirateve të Bashkuara Arabe, me 2 dhjetor 1971, dhe e mbajti atë post derisa ndërroi jetë, në vitin 2004. Presidenti aktual i Emirateve të Bashkuara Arabe është Shejh Khalifa ibn Zâjid Âl Nehjân, post të cilin e mori që nga Nëntori i vitit 2004.

SISTEMI POLITIK

Emiratet e Bashkuara Arabe janë një shtet federal kushtetues, me shtatë emirate dhe gëzojnë sovranitet të plotë. Sipas kushtetutës së Emirateve, sistemi politik i vendit bazohet në pesë pushtete: Këshilli i Lartë i Unionit, Presidenti dhe zëvendësi i tij, Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar Federal dhe Gjykata Federale.

EKONOMIA

Ekonomia e federatës kryesohet nga nafta, e prodhuar kryesisht në emiratit Ebu Dhabi. Më i pasuri i emirateve, Ebu Dhabi, përmban një nga përqendrimet më të mëdha të rezervave të provuara të naftës në botë dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në buxhetin kombëtar. Emirati i Dubait, ekonomia e të cilit është e përqendruar më shumë në biznes sesa në naftë, shërben si një qendër tregtare dhe financiare për diversitetin ekonomik.

Nafta u zbulua në Ebu Dhabi në vitin 1958 dhe qeveria e këtij emirati

zotëron një interes kontrollues mbi të gjitha kompanitë prodhuese të naftës në federatë.

Ebu Dhabi siguron rreth 95 % të prodhimit të naftës në vend, ku prodhimi i naftës dhe gazit natyror kontribuon në rreth një të tretën e PBB-së së vendit.

Sipas Raportit Botëror të lëshuar nga Forumi Ekonomik Botëror për vitin 2019, Emiratet e Bashkuara Arabe renditen në vendin e 25-të në nivel botëror.

Sipas Raportit Vjetor Statistikor të vitit 2018, të bërë nga OIAPEC (Organizata e Vendeve Arabe Eksportuese të Naftës), Emiratet e Bashkuara Arabe zotërojnë 6.7% të rezervave të naftës në botë, duke zënë kështu vendin e gjashtë në botë për rezervat e naftës dhe të gazit natyror.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

1. <https://www.gcā.gov.ae/ar/UAE/Pages/AboutUAE.aspx>
2. Tārih el Âlem el Islāmi el Hadīth vel Muāsir, Ismail Ahmed dhe Shakir Mahmūd, 2004
3. El Bidāje ven- Nihāje
4. <https://u.ae/ar-AE/about-the-uae>
5. <http://www.ahewar.org/debat/show.art.asp?aid=21527>
6. https://web.archive.org/web/20100128060142/http://www.ām.gov.ae/chronology/index_a.htm
7. <https://www.britannica.com/place/United-Arab-Emirates/Languages-and-religion#ref45239>



Prof. dr. Mehmet Gormez

Qytetërimi islam është një qytetërim i fjalës. Krijuesi ynë i Plotfuqishëm i dërgoi revelatën hyjnore njerëzimit duke zbritur Kur'anin Famëlartë si një fjalë të shpallur. Ademi (a.s.) u krijua me një "fjalë", ashtu siç u krijua edhe vetë universi me urdhrin "Bëhu!" Ademiti (a.s.) iu mësuan emrat e krijesave për "fjalën". Allahu i Madhëruar i krijoi njerëzit në gjuhë të ndryshme dhe e përmendi këtë si një nga argumentet e ekzistencës së vet. Shkurtimisht, fjala është një argument me karakter mrekullor përmes së cilës njeriu shfaqet drejt universit dhe shpalos atë që bart në shpirtin e tij.

Allahu i Madhëruar ka theksuar vlerën e fjalës duke shprehur se çdo shprehje që artikullohet nga goja regjistrohet nga engjëjt mbikëqyrës: "...dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë)."- (Kaf, 18) Veçoria e parë që duhet kërkuar tek fjala është të qenët e drejtë, domethënëse dhe e dobishme. Për më tepër, fjala duhet t'i përshtatet dhe t'i shërbejë të vërtetës dhe të drejtës. Fjala përcakton jo vetëm sjelljen e njeriut, por edhe personalitetin e tij. Prandaj, "Fjala është pasqyrë e shpirtit."

Fjala ndërtohet mbi tre parime themelore që përfshijnë, vërtetësinë, etikën dhe estetikën. Nëse shqyrtojmë ajetet kur'anore që lidhen me fjalën, shohim se Kur'ani thekson këto tri

QYTETËRIMI I FJALËS

dimensione të fjalës. Kur muslimanët hodhën themelet e shkencave islame, për shkak të një vëmendjeje të veçantë që i kanë kushtuar raportit të fjalës me kuptimin dhe vërtetësinë, pothuajse të gjitha këto shkencë u shfaqën për të zbuluar marrëdhënien e saj (fjalës) me të vërtetën, urtësinë dhe etikën. Kështu, shumë çështje të trajtuara në metodologjinë e jurisprudence islame (usul fik'h) zbulojnë dimensionin e vërtetësisë së fjalës, filozofia islame shfaq dimensionin e urtësisë së fjalës, ndërsa letërsia, dimensionin etik të saj.

Nëse sjellim në vëmendje mbiemrat dhe përcaktorët që i mveshen fjalës "kavl"(fjalë) në Kur'anin Famëlartë do shohim se fjala bart disa aspekte, si: vërtetësia, urtësia, morali dhe etika. Në këtë kontekst, janë përdorur mbiemra me përmbajtje pozitive, si: kavl-i hasen/fjalë e bukur, kavl-i maruf/ fjalë kuptimplote dhe pozitive, kavl-i adl/fjalë e drejtë, kavl-i sedid/fjalë e qëndrueshme-solide, kavl-i tajjib/fjalë e mirë, kavl-i kerim/fjalë e këndshme, kavl-i beliğ/fjalë e qartë, kavl-i mejsur/fjalë e lehtë, kavl-i lejjin/fjalë e butë; si dhe mbiemra me domethënie negative, si: kavl-i su'/fjalë e keqe, kavl-i munkur/fjalë e shëmtuar, kavl-i zur/fjalë e rreme, kavl-i lahin/fjalë e shtrembëruar, kavl-i zuhruf/fjalë e zbukuruar.

Në literaturën tonë të hershme të gjitha llojet e shprehjeve që çenojnë estetikën e fjalës janë trajtuar nën titullin "katastrofë gjuhësore". Kështu, në veprën madhështore të Gazaliut, Ihja-u Ulûmi'd-din, fjalimet dhe diskutimet boshe, fjalët armiqësore, talljet, gënjeshttrat, përgojimet, shpifjet, etj. (Ihja-u Ulûmi'd-din, 3/246), të trajtuara si elemente shkatërruese të etikës gjuhësore, janë ende sot të pranishme si një manifestim i (shprehje e) humbjes së estetikës së të folurit. Fakti që çdo person që flet sot, është i ekspozuar ndaj rreziqeve të

tilla, keqpërdorimi i masmedias për të përhapur masivisht fjalë të panumërta pa asnjë lloj estetike, për më tepër, kthimi i këtyre fjalëve në imazhe dhe artikuj, ka krijuar një lloj "ndotjeje gjuhësore" që natyrshëm ka hapur rrugën e shumë fatkeqësive të tjera.

Është shumë e vështirë të bëhet ndarja midis fjalës dhe sjelljes/veprimit. Vetë fjala është një sjellje. Ai që di të sillet mirë, di edhe të flasë mirë. Kjo e vërtetë në Kur'anin Famëlartë shprehet me fjalët: "O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t'ju bekojë veprat tuaja dhe do t'ju falë gjynahet." - (Ahzab, 70-71) Përkushtimi ndaj fesë dhe fetarizimi duhet të manifestohen si sjellje dhe jo si fjalë. Një fetarizëm pa virtyte njerëzore dhe morale është thjeshtë një perceptim i rremë. Për këtë arsye, e rëndësishme është që njeriu ta jetojë fetarizmin me sjellje (vepra), jo me fjalë. Qëllimi ynë duhet të jetë një fetarizëm i bazuar në dituri, adhurim të sinqertë dhe moral të bukur, pa qenë e nevojshme të sakrifikojmë fjalën për thelbin dhe as thelbin për fjalën.

Në kohët moderne, vlera e fjalës ka humbur, ndërkohë që është lartësuar imazhi, vizualitetit dhe dukja. Dallimi midis fjalës dhe imazhit është aq i madh sa që nuk mund të tregohet me fjalë. Ndërsa fjala ka një vlerë të madhe në peshoren e të vërtetës, për imazhin nuk vlen e njëjta gjë. Për rrjedhojë, sot myslimanët kanë për detyrë ta lartësojnë fjalën pa e përhumbur veten në shëmbëlltërinë e dukjes dhe imazhit.

Një nga shërbimet më të rëndësishme që duhet të bëjmë ne si thirrës islamë është ta kumtojmë fenë tonë të lartë duke vazhduar të besojmë në vlerën e fjalës dhe duke e lartësuar fjalën e urtë pa rënë pre e një dukjeje dhe imazhi artificial.

Përktheu nga turqishtja:
Msc. Elona SYTARI



QËLLIMI YNË DUHET TË JETË NJË FETARIZËM I BAZUAR NË DITURI, ADHURIM TË SINQERTË DHE MORAL TË BUKUR, PA QENË E NEVOJSHME TË SAKRIFIKOJMË FJALËN PËR THELBIN DHE AS THELBIN PËR FJALËN.

ISLAMI NGA LIBRI DHE ISLAMI NGA JETA

Në ligjëratat dhe hutbet e imamëve, por do të thoja në gjithë diskursin islam, kam përshtypjen se më shumë flitet për Islamin se sa për muslimanët. Islami është feja më e mirë, islami është feja e vërtetë, fe tolerante, superiore. Islami është zgjidhje për të gjitha problemet e muslimanëve, por edhe të jomuslimanëve. Kemi dëgjuar e stërdëgjuar të flitet mbi islamin me superlative, mirëpo kur e shikon gjendjen reale të muslimanëve është në kundërshtim të plotë me teoretizimet e tilla, të cilat që të gjitha janë të vërteta. Islami është ai për të cilin flitet me superlative dhe notat më të larta të vlerësimit, mirëpo muslimanët nuk janë ata që do të duhej të ishin duke marrë parasysh se i kanë të gjitha predispozitat të bëhen të tillë çfarë i ka projektuar Zoti i gjithësisë, jo vetëm si individë por edhe si shoqëri.

Në një konferencë ndërkombëtare që është mbajtur para disa vitesh në Vjen ku pjesëmarrës të shumtë, dijetarë nga Lindja e Afërt dhe e Mesme, me orë të tëra citonin ajete kur'anore dhe hadithe të Pejgamberit (a.s) që kanë të bëjnë me zgjidhjen e shumë probleme të Ummetit musliman. Nëpërmjet atyre ajeteve dhe haditheve ata konkludonin se muslimanët kanë zgjidhjet më të mira për të gjitha padrejtësitë, pabarazinë sociale etj., etj. Mendimtari i njohur

boshnjak akademik Enes Kariq duke u ofruar një kundër-argument këtyre njerëzve që e konsiderojnë veten si "bartës të islamit puritan, i pyet: "Nëse është ashtu, pse kaq shumë të varfër, refugjatë dhe luftëra anë e kënd botës muslimane?"

Kjo lë të kuptohet se Islami nuk qenka një, por më shumë. Autori i përmendur këtë kontradiktë e quan si "Islami nga libri" dhe "Islami nga jeta".

Nuk është e mjaftueshme, vazhdon autori në fjale, të citohet Kur'ani dhe të deklamohen mesazhet e tij për paqen, bashkëjetesën, drejtësinë, barazinë etj., dhe atëherë nga foltorja të thuhet: "Shikoni se si Islami është zgjidhje për çdo gjë!" Për fat të keq, metodologji të tilla të shëmtuara të interpretimit të Kur'anit dhe Islamit janë futur edhe në disa universitete islame dhe muslimane. Aty Islami mësohet si një propagandë e thjeshtë, si një ideologji e zbrastë, pa asnjë lidhje me vuajtjet dhe agoninë e muslimanëve sot në botë. Mistikët islamë thonë: "Ji bija e kohës sate!" ose: "Ji biri i kohës sate!" Kjo do të thotë: Krijoi të mirën dhe bëje atë në pajtim me nevojat e kohës sate.

Mr. Muhidin Ahmeti
(Rahmet pastë)

ISLAMI ËSHTË AI PËR TË CILIN FLITET ME SUPERLATIVE DHE NOTAT MË TË LARTA TË VLERËSIMIT, MIRËPO MUSLIMANËT NUK JANË ATA QË DO TË DUHEJ TË ISHIN DUKE MARRË PARASYSH SE I KANË TË GJITHA PREDISPOZITAT TË BËHEN TË TILLË ÇFARË I KA PROJEKTUAR ZOTI I GJITHËSISË, JO VETËM SI INDIVIDË POR EDHE SI SHOQËRI.

NE VIJMË.., NE EDHE SHKOJMË..!

Sot, shkova në varrezat e qytetit. Një pafundësi proflesh të njohura e të panjohura njerëzish, disa prej të cilëve diç më kujtojnë e, disa, jo..! Një numër i madh emrash. Portrete të njohur, të tjerë të panjohur. Emra të shquar, të tjerë jo edhe aq.

Ishte edhe prof. dr. filani, edhe disa pedagogë pashë. Sa e sa mjekë të njohur, për të cilët, shumë kohë më parë, mendoja se ata nuk vdesin kurrë...

Pastaj pashë edhe ca sportistë, disa komshi, edhe një roje të veshur polic njoha, edhe një mik të njohur, që më pat falur një palë tesbihë të shtrenjtë për simbolikën e tyre, pashë...

Pastaj gjyshi me nanën, edhe motra ime e vogël, dy axhat e mi e ca njerëz të familjes, që kur i pashë varret e tyre se ç'ndjeva, se ç'përfjetova, se ç'më erdhi ndër mend, teksa ulur pranë tyre u lexoja një "Fatiha", bëja një dua e, si në një shirit me xhiro të shpejta, më vinin lloj-lloj kujtimesh, njëri më i bukur se tjetri...

Pastaj gjeta edhe një myfti e një hafiz, një sheh e një dervish, një muezin e një plak të urtë, që e mbaj mend sa hijeëmbël që ishte, teksa vinte në xhami, në heshtjen e moshës së tij plot paqe e dritë...

Muslimanë, të krishterë, ateistë e përtej tyre. Subhanallah, varrezat janë mbushur me emra e portrete, që patjetër që do të vinte një ditë dhe do pushonin në këtë prag...

Edhe mua do më vijë dita. Kur do më vijë dita ime? Ku do më vijë dita ime? A thua do më plotësohet lutja..?

Ne vijmë pa u pyetur dhe largohemi pa u pyetur. Ne vijmë që të ndërtojmë, por shpesh bëjmë të kundërtën! Ne vijmë që të mbjellim atë që do të korrim pas pragut të varrit..!

Ne vijmë.., ne edhe shkojmë..! (Subhanallah.., edhe shkojmë... Sa pak mendojmë..!)

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 22 qershor 2020





Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Në këtë shkrim do të flasim për një dialog që ka ndodhur mes dy hoxhallarëve të njohur. Shekik El-Belhi dhe Hatim El-Esam. Shekik El-Belhi, ka qenë një personalitet i shquar në historinë islame. Ai njihej për dijet e thella, urtësinë, adhurimin dhe zuhdin. Ka ndërruar jetë në vitin 194 h.

Hatim El-Esam ka qenë një njeri shembull, një adhurues dhe këshillues i madh, i cili ishte orator i madh. Prej urtësisë së madhe që ai ka pasur është quajtur Llukmani i këtij ymeti. Ka ndërruar jetë në vitin 237 h.

Këtë dialog e ka përmendur imam Dhehebiu në Sijer A'lam En-Nubela (Historia e dijetarëve fisnik) tek jetëshkrimi i hoxhës Hatim El-Esam. Gjithashtu këtë dialog e ka përmendur edhe imam Gazaliu në Ihjau-Ulumiddin. Prej dobive të shumta që ka ky dialog është se edhe shumë dijetarë të tjerë e kanë përmendur në librat e tyre.

Një ditë Shekik el-Belhi e pyeti nxënësin e tij Hatim El-Esam: “Sa kohë ke që më shoqëron mua? Hatimi u përgjigj: “Tridhjetë e tre vite”. Mësuesi e pyeti: “Gjatë kësaj kohe që më ke shoqëruar, çfarë ke mësuar nga unë?” Hatimi u përgjigj: “Kam mësuar tetë çështje”. Shekik El-Belhi kur i dëgjoi këto fjalë u çudit dhe tha: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi”. Shekiku e shikoi këtë si fatkeqësi pasi për tridhjetë e tre vite nxënësi i tij kishte mësuar nga ai vetëm tetë çështje. Shekiku i tha nxënësit: Ke mësuar vetëm tetë çështje? Nxënësi u përgjigj: “Po o mësuesi im, nuk dëshiroj të jem i pasinqertë me ju, por nuk kam mësuar nga ju përveç këtyre tetë çështjeve. Atëherë mësuesi i tha: “Mirë, më lejo që t’i dëgjoj këto tetë çështje”. Dhe Hatimi vijoi:

1- Duke e studiuar këtë botë, kam parë që çdo njeri ka dikë që e do dhe e simpatizon. Por miqtë e secilit e përcjellin atë deri te varri dhe pastaj

TETË ÇËSHTJE JETËSORE

ndahen nga ai duke e lënë vetëm. Prandaj për mik timin më të mirë zgjidha veprat e mira. Të cilat së bashku me mua do të hyjnë në varr. Mësuesi i tha: “Të lumtë o Hatim, më trego çfarë është e dyta?”.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Tri gjëra e përcjellin të vdekurin deri tek varri: familja e tij, pasuria e tij dhe veprat e tij. Dy kthehen kurse një mbetet me të. Kthehet familja dhe pasuria e tij, kurse me të mbesin veprat e tij”.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Më erdhi Xhibrili (a.s) e më tha: O Muhamed, jeto sa të duash, por dije se një ditë ke për të vdekur. Duaje kë të duash, por dije se prej tij ke për t’u ndarë. Puno çfarë të duash, por dije se atë (që punon) ke për ta gjetur”.

2- Mendova rreth fjalëve të Allahut: “Ai që frikësohet madhërisë së Zotit të tij dhe e frenon veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin”. Duke e ditur se fjalët e Allahut janë të vërteta u përpoqa ti frenoja dëshirat e mia derisa u bëra i përpiktë në bindjen ndaj Allahut.

3- Mësova se çdo njëri posedon diçka me vlerë të cilën mundohet ta ruaj pastaj i lexova fjalët e Allahut: “Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme”. dhe vendosa që çdo gjë që ka vlerë për mua t’ia drejtoj Allahut që të mbetet tek Ai.

4- Mësova që krijesat e Allahut e çmojnë tej mase pasurinë, postin, namin dhe prejardhjen. Kur i lexova fjalët e Allahut: “Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij”. Për këtë u orientova në devotshmëri, në mënyrë që tek Allahu (xh.sh) të jem prej të nderuarve. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vërtet, Allahu nuk shikon në fizionomitë dhe pasuritë tuaja, por shikon në zemrat dhe veprat tuaja!”.

5- Mësova që njerëzit sulmojnë, urrejnë, i fyejnë të tjerët për shkak të zilisë dhe smirës. Kur i lexova fjalët e Allahut: “Ne jemi ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët”. dhe vendosa të mos shpreh zili dhe urrejtje ndaj askujt sepse ajo e cila më është caktuar patjetër do të mbërrijë tek unë.

6- I pashë njerëzit sesi armiqësohen me njëri-tjetrin për arsye dhe qëllime të ndryshme, pastaj mendova thellë rreth

fjalës së Allahut:

“Me të vërtetë, shejtani është armiku juaj, andaj konsiderojeni edhe ju atë si armik!”. Mësova se nuk vlente armiqësia ndaj askujt, përveç shejtanit.

7- Pash se si njerëzit e nënçmojnë vetën duke vrapuar pas pasurisë dhe pasi i lexova fjalët e Allahut: “S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij.” kuptova se edhe unë jam njëra prej atyre gjallesave prandaj u angazhova me detyrat e mia ndaj Tij i bindur se ato që mi ka caktuar pa dyshim do të mbërrijnë tek unë.

PASH SE NJERËZIT MBËSHTETEN NË GJËRA TË NDRYSHME, DIKUSH NË TREGTINË E TIJ, DIKUSH NË ZANATIN E TIJ, DIKUSH NË SHËNDETIN E TIJ OSE NË DIÇKA TJETËR. UNË VENDOSA TË MBËSHTETEM TEK ALLAHU I CILI THOTË: “ALLAHU I MJAFTON KUJTDO QË MBËSHTETET TEK AI.”

Siç e shohim, sot shumicës së njerëzve nuk i intereson se prej nga e fitojnë pasurinë, prej hallallit apo prej haramit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Do të vij një kohë kur njerëzve nuk ju intereson se nga e fitojnë pasurinë, prej hallallit apo prej haramit”.

8- Pash se njerëzit mbështeten në gjëra të ndryshme, dikush në tregtinë e tij, dikush në zanatin e tij, dikush në shëndetin e tij ose në diçka tjetër. Unë vendosa të mbështetem tek Allahu i cili thotë: “Allahu i mjafton kujtudo që mbështetet tek Ai.”

Shekik El-Belhi pasi i dëgjoi çështjet që nxënësi kishte mësuar nga ai. Mësuesi u lut për të: “Allahu të dhëntë suksese. Unë kam lexuar Teuratin, Inxhilin, Zeburin dhe Kuranin. Dhe kam parë se të katër librat e shenjtë silleshin rreth këtyre tetë çështjeve. Kush punon me këto parime ka punuar me të katër librat e shenjtë”. Përmbajuni këtyre tetë rregullave, parimeve, çështjeve se krejt dituria është në to.

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT VELINAJ

PAK HISTORI:

- Xhamia Velinaj ndodhet në Njësinë Administrative Ana e Malit, zona Shkodër. Ajo përfaqëson katër lagje si: Velinaj, Vejukaj, Garuc dhe Xhakaj.

- Fshati Velinaj përbëhet prej rreth 66 familje. Fiset më të njohura janë: Alia, Shmidra, Ramja, etj.

- Xhamia Velinaj pas përfundimit të ndërtimit 1-vjeçar ka filluar funksionin e saj në vitin 1993.

- Në këtë xhami nga viti 1993 deri më sot kanë shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve si: H. Halit Mertoshi (Mandi), Xhaferr Alia, Jetmir Braqi, Ermal Dibra, Ahmet Tashtenur, Ajet Suka, Nebi Alia (imam aktual).



- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 14 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme, nga viti 2002 -2020 është rreth 315 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër në kuadër të vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi, pas xhumasë, më 19 qershor 2020 takimin e radhës

me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Velinaj.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përcimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit foli edhe për respektimin e rregullave gjatë procesit mësimor kundër përhapjes së koronavirusit/covid-19 si dhe evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi Nebi Alia, etj.



MYFTIU ME IMAMËT: “DO TË DUROJMË, POR ME DINJITET!”



Ditën e enjte, më 4 qershor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim me një grup imamësh të qytetit dhe fshatit, të cilëve iu drejtua me një këshillë fetare, që lidhet me misionin e imamet në shoqëri.

Gjatë takimit, që vjen edhe pas Muajt të Begatë të Ramazanit, Myftiu falënderoi imamët për sakrificën dhe përkushtimin e tyre, por kërkoi që angazhimi i imamet të jetë më i madh dhe më aktiv në shoqëri.

Myftiu kërkoi nga imamët që të mos mjaftohen me shërbimet e caktuara brenda xhamisë, por të kryejnë obligimin e Thirrjes Islame edhe jashtë dverve të xhamisë, në lagjet e fshatrat ku shërbejnë, në takime e ndeja me njerëzit, sidomos me muslimanët jopraktikantë.

Myftiu tha se dita-ditës hasen vështirësi, pengesa, dashakeqësi, përballje me injorancën dhe fanatizmin,

gjithandëj. “Do të durojmë, por me dinjitet! Do të durojmë, se kjo është tradita e më të mirë të krijesave të Allahut, por do të ruajmë dinjitetin dhe krenarinë tonë, duke mos u përlur para padijes, fanatizmit të verbër, mungesës së respektit, cënimit të shenjtërive, cytjeve të shejtanëve, etj. Do të flasim e do të mbrojmë me dinjitet vlerat tona, pa asnjë hezitim e pa asnjë mëdyshje!” – tha ndër të tjera Myftiu.

Në takim u fol edhe për aktivitetet në vijim si dhe domosdoshmërinë e hedhjes pas krahëve të frikës dhe panikut paralizues të jetës, që mbajti të mbyllur botën për ditë e muaj.

Udhëzime me vlerë për aktivitetin e kurseve të xhamive tona dha edhe përgjegjësi i sektorit të arsimit, teologu Arben Halluni, i cili foli për periudhën e re, pas riaktivizimit të jetës fetare në xhamitë e Shkodrës.

MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E ZUESIT



Mbrëmjen e së shtunës, më 6 qershor 2020, nisi cikli i ri i ligjëratave me temë: “Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon!”, nëpërmjet të cilit Myftinia Shkodër planifikon të zhvillojë takime të shumta me xhematet, si dhe trajtimin e temave me dobi për besimtarët.

Ky cikël nisi me ligjëratën e mbajtur nga përgjegjësi i sektorit të rinisë në Myftininë e Shkodrës, teologu Ervil Kuçi.

Në vasin e mbajtur para të pranishmëve, imami i nderuar trajtoi temën e rinisë muslimane dhe mënyrën e leximit të ajeteve që nxisin formimin e të riut besimtar me virtyet e besimit dhe moralin e fesë.

Imami foli edhe për shembullin e të rinjve të përmendur në suren El-Kehf, ku theksoi se besimi i tyre mbetet pikë referimi për të rinjtë e sotëm që përballen me sprova të shumta në besim e në jetë.

Mbrëmjen e së shtunës, më 13 qershor 2020, në vazhden e ciklit të ri të ligjëratave me temë: “Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon!”, Myftinia Shkodër kishte planifikuar që ligjëratat e saj mbrëmjeje të ishte në xhaminë e Urës së Bunës.

Në ligjëratën e mbajtur para besimtarëve të pranishëm, imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, thirrësi islam Lavdrim Hamja trajtoi temën e përgjegjësisë së muslimanit ndaj fesë së tij, nisur nga thirrja e fesë për të jetuar me dinjitet, i kapur fort pas besimit dhe Islamit, si dhe duke dëshmuar dashamirësi e humanizëm ndaj komshiut dhe tjetrit, kushdo qoftë ai.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili mbajti një ligjëratë rreth domosdoshmërisë së lidhjes me Kur'anin

MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E URËS SË BUNËS



Famëlartë, mësimin e tij, leximin e tij, kuptimin e tij, praktikimin e tij, si dhe të treguarit të kujdesshëm ndaj misionarëve të shumtë, që teksa shfrytëzojnë mjerimin dhe skamjen, përpiqen t'u ndërrojnë fenë

fëmijëve dhe rinisë, me metoda tashmë të njohura.

Cikli i ri i ligjëratave javore do të vijojë edhe në xhami të tjera të qytetit dhe fshatit.

Në një atmosferë vëllazërore, u përkujtua mbrëmjen e së mërkurës, më 17 qershor 2020, 5 vjetori i hapjes së xhamisë së re në lagjen Dudas, në të njëjtin vakëf, ku ndodhej edhe xhamia e vjetër e kësaj lagjeje, para shkatërrimit të saj nga sistemi komunist.

Ligjëratën kryesore të kësaj mbrëmjeje të shënuar e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili vuri theksin tek rëndësia që ka faktorizimi i xhamisë në jetën e përditshme të muslimanit. Ai tha, se historikisht xhamia ka qenë vatra kryesore ku janë edukuar breznitë e muslimanëve dhe ku janë frymëzuar dijetarët dhe heronjtë e shquar të historisë sonë.

Një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe z. Korab Kaja, drejtor i Fondacionit “Mirësia”, i cili falënderoi xhematin e xhamisë së lagjes Dudas për frymën e harmonisë dhe vëllazërisë, për mirëmbajtjen dhe gjallërimin e kësaj xhamie, sikurse shprehu mirënjohje dhe falënderimi për donatorët nga shteti i Kuvajtit, që me mirësinë e tyre i dhuruan i Shkodrës dhe lagjes Dudas këtë xhami të re.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër nderoi me

Falja e namazit të sabahut, të hënën e 22 qershorit 2020, e gjeti xhaminë e lagjes Dërgut me tapetin e ri, duke ofruar një komoditet më tepër për xhematin e kësaj xhamie.

Prej dy ditësh, puna për zëvendësimin e tapetit të vjetër e kthye xhaminë e Dërgutit në një kantier ndërtimi, ku nën drejtimin e imamëve të nderuar H. Ervil Kuçi, H. Altin Nikshiqi dhe djemve të xhematit, u bë e mundur që ky aksion të përfundojë me sukses.

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e saj për donatorin kryesor të kësaj vepre madhore, i cili, me thjeshtësinë e tij karakteristike, ka preferuar të mos i bëhet publik emri, duke dhënë një shembull të mrekullueshëm në shërbimet ndaj xhamisë së lagjes së tij!

U PËRKUJTUA 5 VJETORI I XHAMISË SË RE NË LAGJEN DUDAS



Certifikatë Mirënjohjeje, H. Vehbi Danin dhe myezinin e xhamisë, z. Ismet Unaza për kontributin e madh dhe shërbimet plot përkushtim për xhematin e kësaj xhamie.


XHAMIA E DËRGUTIT ZBUKUROHET ME TAPETIN E RI

Theksojmë se kjo nuk është hera e parë që zotëria në fjalë kontribuon për xhaminë e lagjes së tij!

Njëkohësisht shprehim falënderim për xhematin e xhamisë Dërgut, që janë angazhuar për mbledhjen e fondit shtesë për plotësimin e disa nevojave që ka kjo xhami.

Myftinia Shkodër falënderon edhe të nderuarin Vullnet Vehbi Pishtari, me firmën e tij, prej të cilës morëm ofertën e përshtatshme për cilësinë e tapetit dhe shërbimit në kohë!


Besimtarët e gëzofshin dhe bamirësit i shpërbleftë All-llahu me mirësitë e Tij të pakufishme!



PËRFUNDOJNË PUNIMET DHE LYERJA E XHAMISË SË FSHATIT BARDHAJ

Java që kaloi ishte një javë plot sakrificë e mund për besimtarët e fshatit Bardhaj, të cilët në koordinim me imamin e xhamisë, H. Ilir Dizdari dhe sektorin e vakëfeve pranë Myftinisë Shkodër, bënë të mundur përfundimin e fazës së fundit për kompletimin e xhamisë dhe shërbimet ndaj saj.

Pas sistemimit të oborrit, rrethimit të tij, shtrimit të tapetit të ri, rregullimit të sistemit elektrik, përmirësimit të fonisë dhe lyerjes së ambienteve të brendshme, gjatë datave 17-21 korrik 2020, u realizua edhe lyerja e plotë e fasadave të xhamisë, duke i dhënë asaj një pamje tërheqëse, sidomos në këtë atmosferë të begatë të



përkujtimit të 30 vjetorit të rilejimit me ligj të fesë në vendin tonë.

Më herët, ditën e enjte, më 18 korrik 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim të këtyre punimeve, sikurse ndoqi edhe momente nga kursi i lëndës së besimit në këtë xhami, ku vlerësoi tri prej vajzave, që kanë mësuar përmendësh nga sureja “El-Fexhr” dhe deri tek sureja “En-Nas”.

Kështu, ditë pas dite, xhamia e fshatit Bardhaj, po kthehet në vendin më të dashur për banorët e saj, si dhe pikë referimi për aktivitetet me rininë dhe shërbimet komunitare ndaj xhamisë.

Ditën e mërkurë, më 24 qershor 2020, përfundoi faza e fundit e pastrimit dhe mirëmbajtjes së pjesës së brendshme të kupolave të xhamisë së Parrucës.


Prej ditëve të para të muajit prill 2020, falë edhe angazhimit dhe shërbimeve të muezinit të xhamisë së Parrucës, z. Besnik Saraçi, u arrit që pjesa kryesore e dëmtimeve të akumuluar prej vitesh, të kryhej e të pastrohej.

Më pas, sektori i vakëfeve pranë Myftinisë Shkodër, në prag të Natës së Kadrit dhe Fitër Bajramit që kaloi, vijoi me lyerjen e pjesshme të ambienteve të brendshme të xhamisë së Parrucës.

Ndërkohë sot, u krye me sukses edhe faza e mbetur e këtij aksioni me dobi për xhaminë e Parrucës.

Myftinia Shkodër falënderon vëllaun e nderuar, Zamir Spahija dhe të nderuarin Besar Pashaj, për përkushtimin dhe shërbimin e çmuar për kryerjen me sukses të kësaj faze të rëndësishme.

NJË SHËRBIM ME VLERË PËR XHAMINË E PARRUCËS



All-llahu ia shpërbleftë krejt atyre që punojnë dhe veprojnë në shërbim të xhamive dhe besimtarëve, duke u bërë shembuj që ndiqen në një shoqëri vlerash.

MYFTIU BASHKËBISEDUI ME MOTRAT E SHKOLLËS VERORE, POSTRIBË

Ditën e xhuma, më 26 qershor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, bashkëbisedoi me motrat pjesëmarrëse në Shkollën Verore, pranë Qendrës Kulturore Islame të Postribës.

Myftiu ligjëroi rreth domosdoshmërisë së leximit me urtësi të teksteve kur'anore dhe porosive të Resulull-llahut (a.s.), sidomos që ty atyre që lidhen me rolin dhe pozitën e femrës në krejt fazat e zhvillimit të saj në jetë.

Myftiu tha se Islami nuk e ka bunkerizuar femrën dhe se hixhabi është simbol i identitetit, zhvillimit, hapjes në shoqëri, dijes dhe personalitetit të fortë të vajzës tonë, motrës, bashkëshortes dhe nënës muslimane.

“Sa e sa emra të mëdhenj, si Hatixhe Kubra, Aishe Siddika, Um Seleme, Um Derda, etj., janë modele për t’u ndjekur, por njëkohësisht edhe thirrje e urtë shekullore që na nxit për edukimin e bijave tona për të qenë njerëz të mëdhenj e me kontribute të spikatura në shoqëri, në të gjitha ato fusha që i shkojnë natyrës femërore dhe përkushtimit të saj!” – tha ndër të tjera Myftiu.

Ai iu përgjigj edhe pyetjeve nga të pranishmet, sikurse shpjegoi edhe disa nga ajetet dhe hadithet, që lidhen me rolin e femrës besimtare në jetë.



Myftiu falënderoi organizatorin e kësaj qendre, imamin e nderuar H. Shkëlqim Sykaj, për kontributin e madh dhe interesimin e vazhdueshëm për gjallërimin e aktivitetit islam në zonën e Postribës, por jo vetëm.

NISI TRAJNIMI 10 JAVOR I IMAMËVE TË MYFTINISË SHKODËR



Paraditën e së hënës, më 29 qershor 2020, nisi trajnimi 10 javor i imamëve të Myftinisë Shkodër.

Ligjërata e parë u mbajt nga teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër”, i cili trajtoi temën me titull: “Mjetet e informacionit dhe Thirrja Islame”.

Imami i nderuar u ndal tek rëndësia e mjeteve të informacionit dhe shfrytëzimit të tyre në aktivitetin e përditshëm të thirrësit islam. Ai solli në vëmendje të pjesëmarrësve mënyrat dhe mjetet e larmishme të përdorura nga të dërguarit e Zotit në thirrjen e tyre, si frymëzim për thirrësit islamë në çdo kohë dhe në çdo vend.

Ai theksoi, se ndër mjetet kryesore, që duhet të shfrytëzojë thirrësi islam në ditët e sotme, janë edhe: Fjala, shkrimi, botimet, mediat audio-vizive, rrjetet sociale, etj.



Ky cikël i ri i ligjëratave, që pasohen nga bashkëbisedimi dhe pyetjet drejtuar ligjëruesit, do të vazhdojë për 10 javë, duke bërë të mundur që ligjërues të ndryshëm nga Shkodra dhe jashtë saj, të kenë mundësinë të trajtojnë tema me dobi për nivelin e imamëve dhe thirrësve tanë.



**I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S)
KA THËNË:**

*“Mësoni prej diturive
sa të dëshironi,
se pasha All-llahun
nuk do të shpërbleheni
për mbledhjen e diturive,
derisa të punoni me to!”*



*“Mësojeni dijen
dhe mësoni respektin
ndaj dijes!”*



*“Nëse All-llahu
ia do të mirën
një familjeje,
vendos butësinë
në mes tyre!”*



**Pejgamberi (a.s)
në Haxhin e Lamtumirës:**

"O ju njerëz,

**ZOTI JUAJ ËSHTË NJË,
babai juaj është një;**

**të gjithë ju jeni nga Ademi
dhe Ademi është nga dheu.**

MË I NDERUARI PREJ JUSH

**tek Allahu,
është më i devotshmi ndër ju!"**

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org